



RAPORT

MBI REZULTATET E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT TË NDËRMJETËSIMIT

Tiranë , Qershor 2020



Ky dokument është përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të projektit me temë “Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme!”, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale -A.L.T.R.I
Rruga “Asim Zeneli”, Nr.15, Tiranë, Shqipëri
Web: www.altri.al
Email: gendra.altri@gmail.com info@altri.al
FB: Qendra ALTRI

Ekipi i ekspertëve
Eda Noçka
Adea Pirdeni

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	8
2. METODOLOGJIA	8
3. REZULTATET E MONITORIMIT	11
3.1 NIVELI I NJOHURIVE DHE TË PERCEPTIMIT TË QYTETARËVE LIDHUR ME MUNDËSINË E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE ME NDËRMJETËSIM.....	11
3.2 EFEKTIVITETI I ZBATIMIT TË DISPOZITAVE TË REJA PROCEDURALE PËR NDËRMJETËSIMIN LIDHUR ME REFERIMIN E RASTEVE NGA GJYKATAT/PROKURORËT	16
3.3 EFEKTIVITETI I ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT TË NDËRMJETËSIMIT NGA NDËRMJETËSIT	23
4. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE	28
5. REKOMANDIME	30

Shkurtime

DHASH	Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
KPrP	Kodi i Procedurës Penale
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport monitorimi paraqet dhe analizon rezultatet e monitorimit të kryer gjatë periudhës Dhjetor 2019-Shkurt 2020 në lidhje me njohuritë dhe perceptimin publik lidhur me këtë institut, efektivitetin e zbatimit të institutit të ndërmjetësimit, dhe në veçanti, referimin e rasteve të ndërmjetësimit nga gjykatat/prokurorët. Qëllimi i këtij raporti është që përmes gjetjeve të procesit të monitorimit, të realizuar në bazë të një metodologjie të testuar dhe të mirëpërcaktuar, të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe rritjen e numrit të rasteve për zgjidhje me ndërmjetësim të referuara nga gjykatat/prokurorët.

Nga procesi i monitorimit rezulton se niveli i njohurive të qytetarëve në lidhje me ndërmjetësimin si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve është i ulët. Afërsisht 2/3 e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë informacion në lidhje me këtë mënyrë alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në pjesën më të madhe të rasteve të anketuarit që kanë marrë informacion, shprehen se e kanë marrë këtë informacion kryesisht përmes medias/internetit, dhe më pak nga gjykata, avokati, familjarët etj. Pjesa më e madhe e të anketuarve gjykojnë se ndërmjetësimi është një mekanizëm që vetëm do të zvarrisë procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, ose do të ketë kosto të shtuara. Pothuajse 90% e qytetarëve nuk do të zgjidhnin ndërmjetësimin edhe nëse i sugjerohej nga gjyqtari. Arsye në lidhje me këtë vendimmarrje variojnë nga mungesa e informacionit për këtë mekanizëm, njohuritë e kufizuara ose perceptimet e gabuara lidhur avantazhet e tij në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, mosorientimin e duhur nga gjyqtari/ prokurori për përzgjedhjen e këtij mekanizmi, dyshimet lidhur me profesionalizmin, konfidencialitetin dhe paanësinë e ndërmjetësit, deri tek kostot që lidhen me procesin dhe kompleksitetin e çështjes objekt shqyrtimi gjyqësor.

Të dhënat nga monitorimi i proceseve gjyqësore dëshmojnë se në pothuajse 2/3 e proceseve gjyqësore të monitoruara, gjyqtarët nuk kanë përmendur mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim. Madje edhe kur gjyqtarët informojnë palët në lidhje me ndërmjetësimin, në shumicën e rasteve mjaftohen vetëm duke e përmendur këtë mundësi. Ata pranojnë se si fillim kufizohen vetëm tek parashtrimi i mundësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe vetëm në rast se palët shfaqin interes fillestar vijnë duke shpjeguar më në detaje procesin dhe avantazhet e tij. Në këtë mënyrë, ata nuk zbatojnë një qasje proaktive në parashtrimin e avantazheve tërësore procedurale, kohore dhe financiare të ndërmjetësimit që në fazat e para të zhvillimit të procesit gjyqësor. Vlen të përmendet dhe perceptimi i përgjithshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët shprehen veçanërisht dyshues në lidhje me efikasitetin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. Sipas tyre, referimi i çështjes për ndërmjetësim nga gjykata mund të shihet nga palët që i janë drejtuar dhe kanë zgjedhur gjykatën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes si një veprim procedural paragykues ndaj çështjes, një veprim i cili do të rrisë kostot financiare dhe tejzgjatjen në kohë të procesit nëse ndërmjetësimi rezulton i pasuksesshëm. Përpos këtyre problematikave, gjyqtarët dhe prokurorët konstatojnë një mungesë të koordinimit dhe bashkëpunimit institucional me Ministrinë e Drejtësisë (në vijim MD) dhe Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve (në vijim DHKN) për të lehtësuar procesin e përzgjedhjes së ndërmjetësve të profilizuar, posaçërisht në rastet e ndërmjetësimit në lidhje me subjekte të mitur në konflikt me ligjin.

Në lidhje me të dhënat që rezultojnë nga anketimet e qytetarëve që i janë nënshtruar një procesi ndërmjetësimi rezulton se të anketuarit e moshave nga 18-40 vjeç janë më të prirur të zgjedhin ndërmjetësimin si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në krahasim me grupmoshat e tjera. Ndryshe nga të anketuarit që nuk kanë marrë ndonjëherë pjesë si palë në një proces ndërmjetësimi, qytetarët e anketuar që e kanë përdorur shërbimin e ndërmjetësimit, shprehen të kënaqur me këtë mënyrë zgjidhje mosmarrëveshjeje, posaçërisht me profesionalizmin, sjelljen e ndërmjetësit dhe kohën e zhvillimit të procesit. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se subjektet që janë anketuar janë referuar për anketim nga ndërmjetësit. Për pasojë, do të merret në konsideratë ekzistenca e një tendencë të shtuar drejt vlerësimit pozitiv të performancës së ndërmjetësve. Një nga aspektet e evidentuara si problematike nga anketimi është niveli i tarifave të zbatuara nga ndërmjetësit. Mungesa e dispozitave ligjore dhe rregullatore për reduktimin ose përjashtimin nga detyrimi i pagimit të tarifës së shërbimit të ndërmjetësit veçanërisht për grupet vulnerabël, vlerësohet se mund të ndikojë negativisht në përzgjedhjen e ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Këto gjetje nga monitorimi tregojnë qartësisht mungesën e efikasitetit të zbatimit të ndryshimeve ligjore të realizuara përmes Ligjit nr. 26/2018, datë 17.5.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10385 datë 24.02.2011 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim”” si dhe nevojën imediate për një vizion të qartë nga ana e MD dhe DHKN për të adresuar këtë problematike nga pikëpamja ligjore dhe institucionale. Marrja e masave nga ana e këtyre institucioneve duhet të marrë vëmendje parësore, në kushtet kur sistemi i drejtësisë është i mbingarkuar, si pasojë e vendeve vakante të krijuara në sistemin e drejtësisë nga dorëheqjet dhe shkarkimet nga procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Krahas funksionimit si një valvul shkarkimi për sistemin e drejtësisë, rritja e efikasitetit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim do të rriste mundësinë për zgjidhjen e shpejtë, me kosto minimale kohore dhe financiare të mosmarrëveshjeve.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, disa nga rekomandimet kryesore janë përmbledhur si vijon:

1. Ndërmarrja e fushatave të gjera ndërgjegjëse dhe promovuese nga MD dhe DHKN me qëllim përcimin e informacionit për avantazhet procedurale, kohore, dhe financiare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim në një gjuhë të përshtatshme dhe kuptueshme për individët e të gjitha moshave, niveleve arsimore, si në zonat rurale dhe ato urbane.
2. Parashikimi në Ligjin Nr. 10385 datë 24.02.2011 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim”(i ndryshuar) i referimit të detyrueshëm nga gjyqtari/prokurori për realizimin e një takimi paraprak me ndërmjetësin, përpara se të nisë shqyrtimi gjyqësor, sidomos për kategori të vecanta çështjesh gjyqësore, veçanërisht në rastet e padive me vlerë të vogël dhe proceset gjyqësore me subjekt të mitur në konflikt me ligjin;
3. Parashikimi i mekanizmave për mbikqyrjen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) të zbatimit të detyrimit ligjor për referimin nga gjyqtarët dhe prokurorët duke e përfshirë në sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
4. Publikimi nga MD dhe DHKN i udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave për tarifën e shërbimit të ndërmjetësimit si dhe parashikimi ligjor i

mundësisë së përjashtimit nga tarifa ose reduktimit të tarifës për subjekte që u përkasin grupeve në nevojë;

5. Në formularin që i vihet në dispozicion të pandehurit/personit nën hetim/të miturit në konflikt me ligjin të shtohet edhe parashikimi i mundësisë së zgjidhjes me ndërmjetësim, kur kjo e fundit është e mundur të aplikohet;
6. Organizimi i trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe njohjen me praktikën më të mirë në lidhje me referimin e rasteve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim.
7. Ndërmarrja e hapave konkrete nga DHKN për profilizimin e ndërmjetësve, me fokus të veçantë ndërmjetësit që angazhohen në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me subjekte të mitur në konflikt me ligjin;
8. Zhvillimi në mënyrë periodike i trajnimeve të ndërmjetësve me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre profesionale, prezantimin me metodat efektive bashkëkohore, në funksion të rritjes së besimit të qytetarëve tek kjo mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
9. Lidhja e një marrëveshje bashkëpunimi midis DHKN dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë për ngritjen e urave të bashkëpunimi midis dhomave për koordinimin dhe orientimin e rasteve që mund të orientohen drejt zgjidhjes me ndërmjetësim;
10. Zhvillimi i takimeve të përbashkëta midis KLGJ, KLP, DHKN, DHASH me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë promovuese të këtij instituti përmes miratimit të udhëzuesve të përbashkët që detajojnë parashikimet ligjore dhe që lehtësojnë proceduralisht shfrytëzimin e institutit të ndërmjetësimit;
11. Kontrolli periodik i ushtrimit të veprimtarisë dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit nga ndërmjetësit me integritet dhe profesionalizëm përmes inspektimeve nga MD;
12. Vlerësimi i mundësisë së përfshirjes së klinikave të ligjit në fakultete dhe pedagogëve ndërmjetës në proceset e ndërmjetësimit të referuara nga gjykata ose me nismën e palëve, me qëllim rritjen e profesionalizimit dhe besueshmërisë në ofrimin e këtij shërbimi ndaj qytetarëve.

1. Hyrje

Rishikimi i legjislacionit në kuadër të reformës në drejtësi përfshiu ndër të tjera dhe harmonizimin e legjislacionit procedural civil dhe penal me legjislacionin për ndërmjetësimin.¹ Këto ndryshime kishin për synim, ndër të tjera, përcaktimin e mekanizmave për nxitjen e shfrytëzimit të ndërmjetësimit si një mënyrë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Duke marrë në konsideratë gamën e gjerë të mosmarrëveshjeve të regjistruara në gjykata, zgjidhja e mosmarrëveshjeve përmes ndërmjetësimit do të funksiononte jo vetëm si një valvul shkarkimi i punës në gjykata, por dhe si një mënyrë më e shpejtë dhe efektive e realizimit të dhënies së drejtësisë. Ndër ndryshimet më cilësore që u parashikuan në ligjin procedural, konkretisht Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, konsistonin në parashikimet mbi referimin e rasteve tek ndërmjetësimi nga gjykatat/prokurori. Pavarësisht këtij parashikimi, rastet e referuara nga gjykatat kanë rezultuar të jenë në numër shumë të vogël.

Bazuar në të dhënat mbi numrin shumë të ulët të rasteve të ndërmjetësimit, Qendra ALTRI realizoi një analizë ligjore të hollësishme të problematikave që kanë rezultuar në zbatimin e kufizuar të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve dhe të referimit të rasteve për ndërmjetësim nga gjykatat/prokurori. Kjo analizë shërbeu si bazë për realizimin e procesit të monitorimit në terren me qëllim verifikimin në praktikë të efektivitetit të zbatimit të legjislacionit në këtë fushë.²

Ky raport synon të paraqesë rezultatet e monitorimit të kryer gjatë periudhës Dhjetor 2019-Shkurt 2020 në lidhje me njohuritë dhe perceptimin publik lidhur me këtë institut, efektivitetin e zbatimit të institutit të ndërmjetësimit, dhe veçanërisht referimin e rasteve të ndërmjetësimit nga gjykatat/prokurorët. Qëllimi i këtij raporti është të kontribuojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe rritjen e numrit të rasteve të referuara nga gjykatat/prokurorët nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve konkrete.

Përfituesit kryesorë të rezultateve të këtij procesi monitorimi do të jenë publiku i gjerë, si dhe gjyqtarët, prokurorët, ndërmjetësit, organet politikëbërëse dhe ligjvënëse.

2. Metodologjia

Metodologjia e monitorimit është realizuar bazuar në objektivat e projektit "*Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme!*", zbatuar nga Qendra ALTRI me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, dhe është hartuar në përputhje me gjetjet e analizës ligjore dhe vështirimit krahasues të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim.


Për realizimin e procesit të monitorimit është shfrytëzuar kombinimi i tre metodave kryesore, të cilat kanë konsistuar në: monitorimin e seancave gjyqësore, anketimin e qytetarëve, intervistat gjysëm të strukturuar me gjyqtarë, prokurorë dhe ndërmjetës.

¹ Ligj nr. 26/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 385, datë 24.2.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".


² ALTRI, Analizë e kuadrit ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim", Shtator 2019, <https://altri.al/wp-content/uploads/2020/06/ANALIZ%C3%8B-LIGJORE-MBI-INSTITUTIN-E-NDERMJETESIMIT-SHTATOR-2019.pdf>

Në lidhje me **monitorimin e seancave gjyqësore**, Qendra ALTRI realizoi një monitorim 3 mujor përmes një kalendari të mirëpërcaktuar duke monitoruar 658 seanca gjyqësore pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Korçës për çështje të regjistruara pas datës 1 qershor 2018, kohë në të cilën kishin hyrë në fuqi ndryshimet ligjore në ligjin për ndërmjetësimin, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale dhe ishte miratuar Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit. Në lidhje me përzgjedhjen e çështjeve civile³, familjare⁴, penale⁵ janë përzgjedhur ato lloje gjykimesh që në varësi edhe të rrethanave të objektit të gjykimit mund të konsiderohen më të përshtatshme për t'u zgjidhur me ndërmjetësim.⁶ Nga të dhënat e monitorimit rezultojnë se rreth 48% e çështjeve të monitoruara kanë qenë çështje civile, 30% familjare dhe 22% çështje penale. Nga seancat e monitoruara, rreth 34% e seancave të monitoruara kanë qenë seanca përgatitore, ndërsa 66% ishin seanca gjyqësore. Me qëllim garantimit të mbledhjes së të dhënave relevante për këtë monitorim, metodologjia e monitorimit të seancave u testua dy javë përpara fillimit të monitorimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Grafik nr.1: Lloji i çështjeve gjyqësore të monitoruara



Grafik nr.2: Përqindja sipas tipologjisë së seancave



Anketimet janë realizuar me individë që kanë qenë ose janë aktualisht palë në një proces gjyqësor dhe individë që i drejtohen gjykatës në kuadër të shërbimeve që ofron gjykata me qëllim matjen e nivelit të njohurive të të anketuarve, por edhe vjeljen e perceptimit të tyre në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. Me qëllim përfundimin e rezultateve statistikisht të vlefshme, u realizua një kampion prej 1000 anketash, përkatësisht 250 individë për secilin qytet: në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë.

Pjesë e procesit të anketimit kanë qenë edhe individë që kanë qenë palë në një proces ndërmjetësimi dhe anketimi i tyre ka paraqitur disa problematika. Identifikimi i individëve që kanë

³ Në lidhje me përzgjedhjen e çështjeve civile, për qëllime të monitorimit u zgjedhën paditë nga seksioni “Padi të tjera kontraktuale” me qëllim evidentimin e padive të cilat janë ose padi me vlerë të vogël në përputhje me nenin 162/a të Kodit të Procedurës Civile si edhe padi të tjera civile për të cilat, në varësi edhe të rrethanave të çështjes mund të konsiderohen më të përshtatshme për t'u zgjidhur me ndërmjetësim.

⁴ Për sa i përket çështjeve familjare u përzgjedhën ato çështje ku baza ligjore janë nenet 66 (marrëveshja për regjimin pasuror martesor), 125 (zgjidhja e martesës me marrëveshje), 134-136 (pajtimi për zgjidhjen e martesës), dhe 221 (konfliktet për fëmijën) të Kodit të Familjes.


⁵ Në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, çështjet penale u zgjedhën ato me objekt gjykim të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal, të cilat janë vepra penale të iniciuara nga viktimat akuzuese. Ndër këto çështje do të synohet të përzgjedhën dhe çështje me palë të miturit në konflikt me ligjin si dhe viktimën akuzuese, me qëllim monitorimin e zbatimit të nenit 63 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁶ Duke qenë se Gjykata e Shkallës së parë Tiranë ka një numër shumë më të madh çështjesh të regjistruara në vit, që arrijnë nga 6 herë deri në 14 herë më të lartë se gjykatat e tjera objekt monitorimi, numri i seancave të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte llogaritur së paku 2 deri në 3 herë më lartë se në këto gjykata. Të dhënat janë përfutur nga Vjetari Statistikor i vitit 2018 i Ministrisë së Drejtësisë.


qenë palë në një proces ndërmjetësimi ka qenë i vështirë për arsye se kërkonte bashkëpunimin me ndërmjetësit dhe mund të cenonte vërtetësinë e të dhënave. Gjithashtu, dhe në kuadër të respektimit të konfidencialitetit të të dhënave të palëve në një proces ndërmjetësimi, anketimi nuk do të mund të zhvillohej drejtpërdrejtë me palët por nëpërmjet ndërmjetësit. Rrjedhimisht, për identifikimin e palëve në një proces ndërmjetësimi, anketuesit kanë komunikuar drejtpërdrejtë me individë që janë referuar tek ndërmjetësimi nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe që i janë nënshtruar këtij procesi. Për këtë arsye, numri i anketave të zhvilluara me individë palë në një proces ndërmjetësimi është i ulët, vetëm 12 anketa (9 u zhvilluan në qytetin e Vlorës dhe 3 në Tiranë). Megjithatë, pavarësisht numrit të ulët të të anketuarve të dhënat e përfuara janë pasqyruar në këtë raport pasi konsiderojmë se ato japin një vlerësim të përgjithshëm lidhur me ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimi. Vlen të theksohet se për secilin nga anketimet e mësipërme (individë që kanë qenë ose janë aktualisht palë në një proces gjyqësor ose që i drejtohen gjykatës në kuadër të shërbimeve që ofron gjykata dhe individë që kanë qenë palë në një proces ndërmjetësimi) janë përgatitur pyetësor të veçantë dhe të dhënat e përfuara prej tyre janë analizuar veçmas në këtë raport.

Në anketime është synuar që të ketë përfaqësim nga të gjitha grupmoshat, gjinitë, dhe të gjitha nivelet e arsimit.


Grafik nr.3: Grupmosha e të anketuarve



Grafik nr.4: Gjinia e të anketuarve



Grafik nr.5: Niveli arsimor i të anketuarve



Krahas sa më sipër, janë realizuar **60 intervista gjysëm të strukturuar**⁷ me gjyqtarë, prokurorë, dhe ndërmjetës⁸ me qëllim evidentimin e problematikave që kanë çuar në zbatimin e kufizuar të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve, eficientë e dispozitave të reja ligjore procedurale lidhur me referimin e rasteve të ndërmjetësimit, si dhe mangësi të tjera.

Gjatë procesit të monitorimit janë mbajtur parasysh parimet e barazisë e mos-diskriminimit, paanësisë, respektimi i anonimitetit, dhe i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Formularët e monitorimit të seancave gjyqësore, pyetësi, lista e pyetjeve drejtuar të intervistuarve dhe udhëzuesit për monitoruesit/anketuesit/intervistuesit janë vendosur si shtojca të këtij raporti.


3. Rezultatet e monitorimit

3.1 Niveli i njohurive dhe perceptimi i qytetarëve lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim

Niveli i njohurive të qytetarëve për mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që ata kanë ose mund të kenë është përcaktues si në ushtrimin e të drejtës së tyre për akses efektiv në drejtësi, ashtu edhe në shmangien e mbingarkesës së gjykatave me konflikte që mund të zgjidhen jashtëgjyqësisht. Anketimi është fokusuar në dy aspekte kryesore: në matjen e njohurive që kanë të anketuarit palë në një proces gjyqësor ose ata që i janë drejtuar gjykatës për të marrë një shërbim; si dhe në perceptimin e tyre në lidhje me këtë mundësi të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Këto dy aspekte janë ngushtësisht të ndërlidhur për shkak se, në shumicën e rasteve, mungesa e informacionit mund të shpjegojë në perceptimin e gabuar në lidhje me dimensionet e këtij instituti, dhe mundësitë që ai ofron. Të dhënat e përfuara nga anketimi janë krahasuar me të dhënat e procesit të monitorimit të seancave gjyqësore dhe të intervistimit të gjyqtarëve/prokurorëve dhe ndërmjetësve.

Statusi i individëve të anketuar në procesin gjyqësor është paraqitur në grafikun më poshtë, ku pjesa më e madhe e tyre kanë qenë palë në procese civile, dhe vetëm 10% e tyre kanë qenë palë në procese penale.

Grafik nr.6: Cilësia e individit në procesin gjyqësor




⁷ Duke qenë se në qytetin e Korçës dhe të Vlorës nuk rezultojnë të jenë pesë ndërmjetës, për shkak se shumë ndërmjetës nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pavarësisht se figurojnë në listën/regjistrin e ndërmjetësve të publikuar nga DHKN si dhe në disa raste ata janë shprehur se kanë hequr dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit për arsye të ushtrimit të veprimtarisë së avokatit dhe rrjedhimisht, shmangien e konfliktit të interesit, atëherë dhe me qëllim plotësimin e numrit të ndërmjetësve (20 në total), janë ndërmarrë intervista me ndërmjetës që ushtrojnë veprimtarinë në qytete të tjera.

⁸ 15 për secilin qytet (5 gjyqtarë, 5 prokurorë, 5 ndërmjetës në nivel Qarku).


Për sa i përket nivelit të njohurive të të anketuarëve në lidhje me institutin e ndërmjetësimit, rezultatet flasin për nivele shumë të ulta të përqindjes së qytetarëve që janë shprehur se kanë njohuri mbi mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. Konkreisht, vetëm 38% e të anketuarve janë shprehur se kanë informacion mbi ndërmjetësimin, ndërsa **62% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë fare njohuri në lidhje me të**. Këto të dhëna dëshmojnë se afërsisht 2/3 e të gjithë të anketuarve nuk kanë asnjë lloj njohurie në lidhje me këtë institut, mënyrën e funksionimit dhe avantazhet e tij. Rezultatet e anketimit vlerësohen veçanërisht problematike edhe për shkak të faktit se të anketuarit nuk janë qytetarë të zgjedhur në mënyrë rastësore, por janë qytetarë që kanë lidhje me gjykatën, kanë qenë ose janë palë në një proces gjyqësor, në një proces ndërmjetësimi, apo individë që i drejtohen gjykatës për të marrë shërbime pranë saj.

Grafik nr.7: Pyetja “Keni informacion mbi ndërmjetësimin si mundësi e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë procesit gjyqësor?”



Nga rrethi i të anketuarëve që janë shprehur se kishin marrë informacion në lidhje me ndërmjetësimin, pjesa më e madhe e tyre, me rreth **34 % e të të gjithë anketuarëve, shprehen se kanë marrë informacionin përmes medias/internetit**, vetëm në **22% të rasteve informacioni është marrë nga gjykata/prokurori**, ndërsa në raste të tjera informacioni është marrë nga avokati, familjarë, ose pala tjetër ndërgjyqëse. Nga këto të dhëna rezulton se qytetarët marrin informacion në masë të konsiderueshme nga mediat si ato tradicionale dhe ato online. Kjo dëshmon se mediat përbëjnë një mjet shumë të rëndësishëm për përhapjen e informacionit dhe përcimin e njohurive të qytetarëve lidhur me mënyrat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në vetëm në afro 1/5 e rasteve rezulton se informacioni është marrë nga gjykata, tregues i cili dëshmon për mungesën e respektimit nga e gjyqtarëve/prokurorëve të detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi për informimin e palëve për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

Grafik nr.8: Pyetja “Nga e keni marrë informacionin në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së çështjes me anë të ndërmjetësimit?”




Të dhënat nga anketimi të ballafaquara nga ato me intervistat me gjyqtarët tregojnë se në 20 gjyqëtarë të intervistuar, shumica e tyre, 16 gjyqtarë, pohojnë se i informojnë palët, ndërkohë që 4 prej tyre pranojnë se nuk i informojnë palët. Argumentet që gjyqtarët paraqesin për mosinformimin e palëve mund të përmbledhen si vijon:

- ✓ fakti që palët i janë drejtuar gjykatës është tregues parësor që vërteton vullnetin e tyre për të zgjidhur mosmarrëveshjen gjyqësisht;
- ✓ refuzimi i palëve për të zgjidhur çështjen me ndërmjetësim edhe kur i është sjellë në vëmendje nga gjykata;
- ✓ mosvënia në dispozicion gjyqtarëve të një liste të ndërmjetësve në mënyrë që të jenë në gjendje t'u referojnë palët.

Ndërkohë situata paraqitet e ndryshme në rastin e prokurorëve, nga 20 prokurorë të intervistuar, 12 prej tyre shprehen se nuk i informojnë palët, ndërsa 8 prej tyre shprehen se i informojnë duke vlerësuar situatën rast pas rasti, në përputhje me parashikimet ligjore. Ashtu siç rezultoi nga intervista me gjyqtarët, edhe prokurorët theksojnë si një pengesë për zbatimin e detyrimit për informimin e palëve është mungesa e një liste me ndërmjetës të profilizuar për zgjidhjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin.


Në kushtet kur qytetarët nuk janë të informuar në lidhje me ndërmjetësimin është e shpjgueshme që do të ketë një hezitim në përzgjedhjen e kësaj forme zgjidhje mosmarrëveshje, ashtu dhe besueshmëri të ulët në profesionalizmin dhe integritetin e ndërmjetësit si një alternativë ndaj gjykatës. Kur të anketuarit janë pyetur nëse do të merrnin në konsideratë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre me ndërmjetësim **nëse do të paraqitej si mundësi nga gjyqtari, 75% e tyre nuk do të pranonin këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.** Ky rezultat gjykohet se është rrjedhojë e mungesës së informacionit të duhur ose i mungesës së besimit tek instituti i ndërmjetësimit.

Grafik nr.9: Pyetja “Nëse zgjidhja me ndërmjetësim do të parashtrohej/ishite parashtruar si mundësi nga gjyqtari a do ta merrnit në konsideratë?”



Po ashtu, gjatë procesit të monitorimit në gjykata ka rezultuar se, në 96.3% të rasteve palët në proceset gjyqësore të monitoruara nuk e kanë kërkuar aplikimin e ndërmjetësimin, në 2.1% e ka kërkuar vetëm njëra palë dhe vetëm në **1.5% të rasteve palët kanë shprehur vullnetin e përbashkët për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre me anë të ndërmjetësimin**. Të dhënat e përftuara nga anketimi dhe ato nga monitorimi rakordojnë pikërisht tek numri shumë i vogël i referimeve vullnetare nga vetë palët.

Grafik nr.10: Pyetja “A është kërkuar nga një nga palët në proces zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?”




Përpos nivelit të njohurive të të anketuarve, pjesa më e madhe e tyre nuk e shohin ndërmjetësimin si një mënyrë efektive për të zgjidhur çështjen në një kohë sa më të shpejtë jashtë dierve të gjykatave, por si një hallkë e cila **thjesht do të zvarriste procesin (31 %)**, ose **do të kishte më shumë kosto se vetë procesi gjyqësor (18%)**. Një pjesë tjetër **(18%) ose kanë dyshime në paanësinë e ndërmjetësit, në përgatitjen profesionale e tij (8%), ose në ruajtjen e konfidencialitetit (5%)**.

Krahas sa më sipër, 20% e të anketuarve kanë zgjedhur alternativën “tjetër” dhe në komentet që kanë dhënë qytetarët gjatë anketimit, një pjesë janë shprehur se janë këshilluar nga avokati/avokatët mbrojtës për të mos zgjedhur këtë alternativë, sepse e gjykojnë rastin e tyre veçanërisht kompleks për t’a zgjidhur përmes ndërmjetësimin. Nga një pjesë tjetër e komenteve thellohet sërish bindja se një pjesë e të anketuarve nuk e kanë kuptuar drejt institutin e

ndërmjetësimi, pasi shprehen se “kërkojnë të përfaqësohen me avokat dhe nuk e konsiderojnë ndërmjetësimin të dobishëm.” Këto perceptime janë rezultat i informacionit të gabuar ose të pamjaftueshëm në lidhje me faktin që jo vetëm se ndërmjetësi nuk zëvendëson avokatin, por pala në një proces ndërmjetësimi gëzon të drejta të plota të mbrojtjes me avokat. Këto perceptime tregojnë gjithashtu punën e pamjaftueshme ose joefektive të kryer nga institucionet përgjegjëse, përfshirë këtu DHKN, MD, ose gjykatat, në drejtim të promovimit të këtij mekanizmi dhe nxitjen e përmirësimit të performancës së shërbimit të ofruar nga ndërmjetësit.

Grafiku nr.12 Arsytet e refuzimit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim



Të dhënat nga anketimi mbështeten edhe plotësohen nga të dhënat e intervistave të zhvilluara me gjyqtarë, prokurorë dhe ndërmjetës. Gjyqtarët e intervistuar nxjerrin në pah disa problematika që kufizojnë zbatimin e duhur të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve, ku ndër kryesorët përmendin:

- ✓ mungesën e informacionit lidhur me këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- ✓ mungesën e një praktike të konsoliduar të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim në Shqipëri;
- ✓ mungesën e besimit tek fuqia zbatuese e marrëveshjes së arritur nga procesi i ndërmjetësimi, krahasuar me fuqinë detyruese të një vendimi gjyqësor. Palët janë të pasigurt nëse pala tjetër do i qëndrojë marrëveshjes që mund të arrihet me ndërmjetësim, fakt i cili mund të bëhet shkak për tejzgjatjen e procesit gjyqësor;
- ✓ rritjen e shpenzimeve procedurale duke e konsideruar procesin e ndërmjetësimi një kosto të shtuar për palët, të cilat kanë paguar fillimisht avokatin për ndjekjen e çështjes gjyqësisht. Gjithashtu, duke qenë se gjatë procesit gjyqësor palët përpiqen të fitojnë gjyqin, kanë edhe pritshmërinë që shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen palës tjetër;
- ✓ mungesën e besimit tek profesionalizmi dhe paanshmëria e ndërmjetësit.

Disa nga problematikat e sipërpërmendura evidentohen edhe nga prokurorët e intervistuar. Ndër to mund të përmendim:

- ✓ Mungesën e informacionit dhe besimit të qytetarëve lidhur me institutin e ndërmjetësimi dhe suksesin e procesit;

- ✓ Pamundësinë e përballimit të kostove të ndërmjetësimit nga ana e familjarëve të të miturve në konflikt me ligjin.

Krahas prokurorëve dhe gjyqtarëve, edhe vetë ndërmjetësit identifikojnë problematika të ngjashme që variojnë nga mungesa e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, tek profesionalizmi dhe paanësia e ndërmjetësve në veçanti. Ata vlerësojnë se mungojnë mekanizmat e duhura për garantimin e një sistemi të trajnimit vazhdues nga DHKN. Gjithashtu, kjo e fundit duhet të rrisë transparencën e veprimtarisë së saj dhe të garantojë promovimin e duhur të këtij shërbimi.

Në analizë të fundit mund të konstatohet se të dhënat e mbledhura sa më sipër hedhin dritë mbi nivelin tejet të ulët të njohurive të individëve lidhur me ndërmjetësimin. Niveli i ulët i njohurive ndikon drejtpërdrejtë në perceptimet e tyre lidhur me disavantazhet që ka zbatimi i këtij instituti. Këto të dhëna tregojnë edhe nivelin e ulët të përmbushjes së detyrimeve të institucioneve publike, kryesisht nga gjykatat, prokurorët dhe DHKN në kuadër të informimit dhe këshillimit të qytetarëve mbi procedurat e ndërmjetësimit. Pavarësisht ekzistencës së DHKN që prej vitit 2013⁹ dhe përgjegjësisë së saj për “informimin e nevojshëm të publikut për veprimtarinë e ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për mundësitë e kontaktimit të ndërmjetësve”¹⁰ të dhënat për një nivel shumë të ulët të njohurive të qytetarëve lidhur me këtë institut, dëshmojnë për mungesën e promovimit efektiv të këtij shërbimi. Gjithashtu, që prej miratimit të ligjit për ndërmjetësimin në vitin 2011, gjykatat kanë detyrimin të ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim¹¹ ndërkohë që të dhënat tregojnë se numri i referimeve për ndërmjetësim nga gjykata është ende i ulët.

3.2 Efektiviteti i zbatimit të dispozitave të reja procedurale për ndërmjetësimin lidhur me referimin e rasteve nga gjykatat/prokurorët

Zbatimi i dispozitave të legjislacionit procedural civil dhe penal, dhe atij specifik për ndërmjetësimin varet në radhë të parë nga sjellja e institucioneve që janë ngarkuar me zbatimin e këtyre dispozitave. Fokusi i monitorimit ka qenë zbulimi i nivelit të zbatimit të parashikimeve ligjore për referimin e rasteve nga gjykatat dhe hulumtimi i arsyeve se përse numri i mosmarrëveshjeve që zgjidhen me ndërmjetësim është aq i vogël.

Nga konstatimet e këtij monitorimi evidentohet se detyrimi i gjykatës, apo sipas rastit i organit të akuzës, për të njoftuar palët ndërgjyqëse për mundësinë e aplikimit të ndërmjetësimit dhe avantazhet që sjell aplikimi i tij në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nuk zbatohet në mënyrë adekuate. Kjo gjetje mbështetet në analizën e treguesve të monitorimit nga ku **në afërsisht 2/3 (62%) të procesve të monitoruara rezulton se palët nuk janë vënë në dijeni** nga gjykata në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, ndërsa në vetëm **38% të rasteve janë vënë në dijeni**. Gjithashtu, monitoruesit komentojnë se përgjatë zhvillimit të procesit tre mujor të monitorimit në gjykata ka pasur një rritje progresive të rasteve nga muaji i parë i monitorimit, në muajin e dytë, dhe në të tretin. Tek kjo tendencë në rritje e dy muajve të fundit,


⁹ Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve është krijuar me ligjin nr. 10 385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” por mbledhja e pare e Dhomës është zhvilluar më 07.07.2013, <http://www.dhkn.gov.al/historiku>

¹⁰ Neni 7, Pika 3/ë, i ligjit nr. 10 385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.

¹¹ Në kuadër të ndryshimeve të bëra në nenin 2 të ligjit nr. 10 385/2011 me ligjin nr. 26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 10 385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” parashikohet detyrimi i gjykatës për të njoftuar, udhëzuar dhe, sipas rastit, informuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme palët për zgjidhjen me ndërmjetësim.

gjykojmë se ka pasur ndikimin e tij edhe zhvillimi i procesit të monitorimit në gjykata në kuadër të këtij projekti.


Grafiku nr.13: Pyetja: “A është përmendur nga gjykata/prokuroria mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?”



□


Të dhënat e mësipërme që rezultojnë nga monitorimi i seancave gjyqësore përputhen pothuaj plotësisht me ato të përfutuara nga anketimi me individë që kanë qenë ose janë palë në procese gjyqësore në kohën e anketimit. **68% e të anketuarve janë shprehur se nuk janë informuar nga gjykata** në seancën përgatitore apo gjatë seancave gjyqësore në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, ndërsa 32% janë shprehur se janë informuar.

Grafiku nr.14: Pyetja: “A është përmendur nga gjykata/prokuroria mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?”




Në kuadër të këtij procesi monitorimi paraqet interes që të analizohet se sa proaktive ka qenë gjykata/prokurori në informimin e palëve mbi mundësitë dhe avantazhet që ofron ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Rezultatet e monitorimit të seancave gjyqësore dëshmojnë se në **64% të rasteve palët në proces nuk janë informuar mbi avantazhet që sjell zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim**, ndërsa në 36% të rasteve janë informuar nga gjykata. Për më tepër, gjatë raportimit, monitoruesit kanë theksuar se gjatë periudhës 3 mujore të monitorimit, numri i rasteve të informimit të gjyqtarëve ndaj palëve në proces ka ardhur në rritje.

Grafiku nr.15: Pyetja: “A i informoi gjykata palët mbi avantazhet e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?”



Gjithashtu, nga procesi i anketimit rezulton se individët palë në një proces gjyqësor që pohojnë të jenë njoftuar nga gjyqtari (në 36% të rasteve) në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me anë të ndërmjetësit, vërtetojnë gjithashtu se në **87% të këtyre rasteve gjyqtarët janë mjaftuar vetëm me informimin e palëve për mundësinë e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim**, në 22% të rasteve gjyqtari i ka informuar palët edhe në lidhje me avantazhet e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim dhe **vetëm 5% e të anketuarve konfirmojnë se është propozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjyqtari që çështja të zgjidhet me ndërmjetësim si alternativa më e mirë.**

Grafiku nr.16: Pyetja: “Zgjidhni pohimin më të saktë”




Këto të dhëna ballafaquar me të dhënat e mbledhura nga anketimet e individëve që i janë nënshtruar një procesi ndërmjetësimi dhe nga intervistat me gjyqtarë/prokurorë dhe ndërmjetës, konfirmojnë gjetjet e mësipërme. Konkretisht, individët e anketuar janë shprehur se në **92% të rasteve gjykata është mjaftuar vetëm me njoftimin e tyre** në lidhje me mundësinë e ndërmjetësit. Të pyetur se deri në çfarë niveli informohen palët, gjyqtarët pranojnë se si fillim ata kufizohen tek informimi i mundësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe në rast se palët shfaqin një interes fillestar, ata vijojnë me shpjegimin më në detaje të procesit të ndërmjetësit dhe avantazheve të tij. Ndërkohë që prokurorët shprehen se i informojnë palët edhe në lidhje me avantazhet që sjell procesi i ndërmjetësit kryesisht për çështjet e iniciuara me ankim nga viktimat akuzuese, kur ka dyshime të arsyeshme të bazuara mbi prova bindëse se i mituri në

konflikt me ligjin ka konsumuar veprën apo kundërvajtjen penale. Ndërmjetësit e intervistuar, nga ana tjetër, kanë opinion diametralisht të kundërt me gjyqtarët dhe prokurorët. Ata shprehen se përgjithësisht palët nuk informohen nga gjykata/prokurori, por edhe kur ky informacion u vihet në dispozicion, realizohet në mënyrë thjesht formale pa u thelluar në avantazhet apo edhe pasojat e zbatimit të kësaj procedure.

Mosnjohja e avantazheve të ndërmjetësimit dhe mosinformimi i duhur nga gjykata ka ndikuar në reagimin e qytetarëve ndaj propozimit të gjyqtarëve për zgjidhjen e çështjeve me ndërmjetësim. **Vetëm në 1% të rasteve palët e kanë pranuar pjesërisht kërkesën e gjykatës,** ndërsa në 3% të rasteve palët kanë shprehur vullnetin e përbashkët për pranimin e propozimit nga ana e gjyqtarit, 35% e palëve në proces e kanë refuzuar propozimin e gjyqtarit, dhe **61% e tyre shprehen se nuk është propozuar nga gjykata mundësia e zgjidhjes me ndërmjetësim.**

Grafiku nr.17: Reagimi i palëve ndaj propozimit të gjyqtarit për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim.



Këto të dhëna statistikore mbi performancën e ulët të gjykatave në informimin e palëve për institutin e ndërmjetësimit konfirmohen edhe nga vetë pohimet e gjyqtarëve/prokurorëve gjatë procesit të intervistimit¹² dhe duhen vlerësuar në kontekstin më të gjerë të zbatimit të legjislacionit për ndërmjetësimin.

Disa prej gjyqtarëve parashtrojnë si problematikë refuzimin e vazhdueshëm të palëve për t’iu referuar këtij instituti dhe kjo, për arsye të nivelit të ulët të njohurive që ata kanë mbi ndërmjetësimin por edhe se palët nuk kanë besim tek fuqia zbatuese e marrëveshjes së arritur nga ky proces. Gjithashtu, gjyqtarët dhe prokurorët shfaqin hezitimin e tyre për të referuar, apo siç shprehen ata për të “insistuar apo marrë rol aktiv në referimin e rasteve”, për arsye se nuk duan të krijojnë përshtypjen tek palët ndërgjyqëse se çështja është paragjykuar dhe nuk po “vlerësohet” sa duhet për t’i dhënë zgjidhje gjyqësisht. Zgjedhja e procedurës së cilës palët dëshirojnë ti nënshtrohen, sipas gjyqtarëve, është një e drejtë e tyre. Për më tepër, shpesh mosmarrëveshja midis palëve është e tillë që zgjidhja me pajtim vlerësohet si e pamundur. Gjyqtarët pranojnë se në rastet kur konstatojnë se palët kanë ndihmë ligjore përmes avokatëve, atëherë ata kufizohen vetëm tek informimi mbi mundësinë e ndërmjetësimit. Disa prej gjyqtarëve vlerësojnë se palët dhe gjykata

¹² Referohu ne fq.15

nuk e konsiderojnë avantazh referimin tek ndërmjetësimi pasi një veprim i tillë, në rastet kur marrëveshja midis palëve nuk arrihet, sjell zgjatjen në kohë të procesit gjyqësor dhe shpenzime shtesë, përveç shpenzimeve të mbrojtjes me avokat. Përpos kësaj, problematika e shpenzimeve shtesë evidentohet edhe në rastet kur marrëveshja arrihet, pasi përpara fillimit të procesit gjyqësor, pala ka paguar një tarifë pranë avokatit në kuadër të përgatitjes së dokumenteve ligjore (psh.përgatitja e kërkesë-padisë) apo përfaqësimit në gjykatë.

Nga intervistat me gjyqtarë/prokurorë dhe ndërmjetës rezulton se ka një tendencë për transferim të përgjegjësisë në lidhje me mosfunksionimin në nivele të kënaqshme të referimit nga gjyqtari/prokurori. Gjyqtarët dhe prokurorët insistojnë në mungesën e koordinimit dhe bashkëpunimin ndërinstytucional. Sipas tyre, MD nuk u ka vënë në dispozicion një listë ndërmjetësish të listuar sipas vendit ku ushtrojnë aktivitetin si dhe profilizimit të tyre. Më konkretisht, prokurorët e specializuar për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve me të mitur në konflikt me ligjin kanë ngritur shqetësimin se nuk u garantohet një listë nga MD me ndërmjetësit e licensuar, të specializuar për trajtimin e rasteve me subjekt të miturin në konflikt me ligjin.

Gjyqtarët dhe prokurorët e intervistuar shprehen gjithashtu se në disa raste avokatët u këshillojnë palëve zgjidhjen e çështjeve në rrugë gjyqësore me qëllim garantimin në vijimësi të ofrimit të shërbimit të mbrojtjes ligjore. Përpos kësaj, sipas tyre përgjithësisht palët nuk e pranojnë ndërmjetësimin, pasi ose nuk kanë besim tek kjo formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ose mendojnë që është e kushtueshme. Ky shërbim ka funksionuar në mënyrë efektive në rastet kur proceset e ndërmjetësimit janë financuar nga donatorë dhe ky shërbim është ofruar falas. Nga ana tjetër, ndërmjetësit, shprehen se ka një neglizhencë nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve në referimin e rasteve, si edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së zgjidhjes me ndërmjetësim për çështjet objekt gjykimi.

Për sa i përket ndryshimeve që solli ligji nr.26/2018 në ligjin 10385 dt, 24.02.2011 “Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve me Ndërmjetësim”, një pjesë e gjyqtarëve dhe shumica e prokurorëve i vlerësojnë pozitivisht këto ndryshime por e lidhin moszbatimin e procedurës së ndërmjetësimit me mungesën e njohurive të qytetarëve lidhur me këtë institut dhe mungesën e ndërmarrjes së fushatave ndërgjegjësuere të vazhdueshme për avantazhet që sjell zbatimi i këtij instituti. Ndërsa disa gjyqtarë e prokurorë të vlerësojnë se eficaenca e dispozitave të reja nuk është provuar ende për sa kohë ato nuk zbatohen plotësisht në praktikë. Gjithashtu, ata vlerësojnë se kuadrit ligjor i mungon parashikimi i mjeteve eficaente për ekzekutimin e marrëveshjes të arritur në procesin e ndërmjetësimit nëse palët ose njëra palë e revokon vullnetin/marrëveshjen. Vlerësimet negative lidhur me eficaencën e ndryshimeve të bëra në ligjin për ndërmjetësimin argumentohen edhe me zgjatjen që ato shkaktojnë në procesin gjyqësor nëse palët nuk e arrijnë marrëveshjen e ndërmjetësimit dhe i rikthehen gjykatës. Për disa gjyqtarë e prokurorë tarifat e shërbimit të ndërmjetësimit konsiderohen të larta dhe vlerësojnë që procesi i ndërmjetësimit duhet të jetë falas, së paku për kategoritë në nevojë. Tarifat e shërbimit të ndërmjetësimit vlerësohen si një element pengues për qytetarët për t’iu referuar këtij instituti pasi konsiderohen si kosto shtesë e procesit gjyqësor. Të tjerë gjyqtarë vlerësojnë se ndryshimet ligjore nuk kanë sjellë asnjë risi dhe se e njëjta procedurë vazhdon të zbatohet. I vetmi ndryshim pozitiv vlerësohet të jetë në parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Nga ana e tyre ndërmjetësit janë shprehur skeptikë në lidhje me efektivitetin e ndryshimeve ligjore pasi, sipas tyre, në praktikë këto ndryshime nuk kanë sjellë pothuajse asnjë impakt pozitiv. Ata identifikojnë si problematikë kryesore mungesën e bashkëpunimit konstruktiv midis

gjykatave/prokurorive dhe institucioneve mbikqyrëse dhe rregullatore (MD dhe DHKN) në lidhje me vënien në zbatim të dispozitave të reja. Gjithashtu, ata identifikojnë si problematikë edhe mungesën e një parashikimi ligjor për rregullimin e tarifave të ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit, faktor përcaktues në rritjen e pasigurisë së qytetarëve në lidhje me shpenzimet që ata do të duhet të mbulojnë nëse zgjedhin këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Nga intervistimet rezulton se për funksionimin eficient të institutit të ndërmjetësimit, palët e intervistuar sugjerojnë që të ketë bashkëpunim ndërmjet institucioneve dhe rritje të numrit të ndërmjetësve të licensuar për trajtimin e rasteve me të mitur në konflikt me ligjin. Trajtimi i diferencuar i rasteve të të miturve në konflikt me ligjin mund të konsistojë kryesisht në krijimin e lehtësirave financiare për këtë kategori. Pjesa më e madhe e veprave penale të konsumuara nga të miturit janë kryesisht vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të nxitura përgjithësisht nga vështirësitë e theksuara ekonomike në familjet e tyre si dhe probleme të tjera sociale, të cilat faktojnë pamundësinë reale të tyre në përballimin e tarifave të procesit të ndërmjetësimit. Në rast se i referohemi ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, ndërmjetësimi në nenin 62 të këtij Kodi parashikohet si një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale e të miturit. Pavarësisht këtij parashikimi, lidhur me shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, Kodi parashikon në nenin 64 pika 8 se “shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit bëhen sipas legjislacionit në fuqi”. Duke iu referuar legjislacionit në fuqi konstatohet se si ligji nr. 10 385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar, ashtu dhe ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” nuk përmbajnë parashikime lidhur me lehtësimin financiar në kuadër të procedurës së ndërmjetësimit të të miturit në konflikt me ligjin por parashikohet vetëm ofrimi i ndihmës juridike parësore në formën e dhënies së këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve¹³.

Së fundi, të pyetur nëse parashikimi në ligj i referimit të detyrueshëm në një takim paraprak me ndërmjetësin do të rriste efikasitetin e zbatimit të procedurës së ndërmjetësimit, gjyqtarët dhe prokurorët shprehen përgjithësisht dyshues. Sipas tyre, një parashikim i tillë ligjor nuk do të ishte zgjidhja e duhur pasi do të humbiste natyra vullnetare e këtij procesi, do të cenoheshin të drejtat e individëve për t’iu drejtuar gjykatës dhe do të sillte si pasojë zgjatjen e procesit gjyqësor në rast se çështja do të rikthehej në gjykatë. Gjyqtarët identifikojnë si faktor përcaktues në rritjen e numrit të mosmarrëveshjeve që zgjidhen me ndërmjetësim, krijimin e besimit të individëve në profesionalizimin dhe aftësitë e ndërmjetësit dhe për këtë propozojnë marrjen e masave të duhura nga DHKN për specializimin e ndërmjetësve në një fushë të caktuar dhe rritjen e kapaciteteve të tyre. Pjesa më e madhe e prokurorëve shprehen se ky institut ka nevojë për më shumë promovim për të nxitur zbatimin e këtij instituti.

Pavarësisht hezitimit për të pranuar mundësinë e një parashikimi ligjor për vendosjen e referimit të detyrueshëm nga gjykata, disa nga gjyqtarët i njohin këtij mekanizmi edhe disa aspekte pozitive, konkretisht:

- ✓ ulja e ngarkesës për prokurorinë dhe gjykatën për çështje me rrezikshmëri të ulët;
- ✓ zbatimi i referimit të detyrueshëm në mënyrë të përkohshme me qëllim njohjen e nevojshme këtij procesi nga palët dhe për të vendosur dhe konsoliduar një praktikë të zbatimit të tij;
- ✓ uljen e kostove për prokurorinë dhe gjykatën;

¹³ Neni 3, shkronja b/iii, i Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

- ✓ zvogëlimi i kohës së zgjidhjes së çështjeve.

Për ndërmjetësit, nga ana tjetër, referimi i detyrueshëm do të sillte rritje të besimit tek kjo formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ata gjykojnë se përcaktimi në legjislacion i referimit të detyrueshëm të një takimi me ndërmjetësin do të krijonte përshtypjen se gjykata/prokurori ka paragjykuar çështjen.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se, pavarësisht parashikimeve ligjore dhe detyrimit që kanë gjyqtarët e prokurorët për të njoftuar dhe udhëzuar palët për mundësinë e zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve, shumica prej tyre nuk e përmbushin këtë detyrim në mënyrën e duhur. Për më shumë, edhe ata të intervistuar që pohojnë se i informojnë palët pranojnë se si fillim kufizohen tek informimi i mundësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe vetëm në rast se palët shfaqin interes fillestar vijnë duke shpjeguar më në detaje procesin dhe avantazhet e tij. Çfarë vlen për tu theksuar është edhe perceptimi i vetë gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët e konsiderojnë referimin e çështjes për ndërmjetësim nga gjykata si një veprim procedural paragjykses ndaj çështjes, që ka kosto të shtuara financare dhe në kohë. Ky perceptim shpjegon më së miri edhe numrin e ulët të rasteve kur palët janë informuar nga gjyqtari/prokurori lidhur me procedurën e ndërmjetësimit. Këto perceptime dhe argumenta të parashtruara nga gjyqtarët analizuar në tërësinë e tyre, kërkojnë megjithatë vëmendjen e institucioneve. Ministria e Drejtësisë dhe DHKN duhet të marrin masa që të vënë në dispozicion të publikut, gjyqtarëve/prokurorëve një listë të përditësuar të ndërmjetësve¹⁴ si dhe të sigurojnë profilizimin e tyre sipas fushave të së drejtës ku ofrohet ndërmjetësimi, duke i dhënë prioritet profilizimit të ndërmjetësve që trajtojnë çështjet e të miturve në konflikt me ligjin. Gjithashtu, paraqet nevojën për rregullim të veçantë edhe shpërndarja territoriale e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit, për pasojë edhe garantimin e aksesit në këtë shërbim, pasi shumica e ndërmjetësve të licensuar e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë.

Veçanërisht shqetësues paraqitet dhe perceptimi i qytetarëve edhe i të intervistuarve për nivelin e lartë të tarifave të këtij shërbimi, të cilat vënë në diskutim përzgjedhjen e ndërmjetësimit si një alternativë më pak e kushtueshme se procesi gjyqësor. Në pamundësi për të vlerësuar këto tarifa pasi udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për tarifat e shpërbimit të ndërmjetësve nuk është i publikuar, arsyet e këtij perceptimi janë vlerësuar duke marrë në konsideratë argumentet e dhëna nga të anketuarit dhe të intervistuarit. Kur një çështje referohet nga gjyqtari tek ndërmjetësimi ekziston rreziku që procesi i ndërmjetësimit të mos rezultojë i suksesshëm dhe çështja të rikthehet për shqyrtim në gjykatë. Palët do të duhet të përballojnë edhe shpenzimet e ndërmjetësimit që në këtë rast përbëjnë një kosto shtesë për procesin në tërësi. Gjithashtu, ky perceptim për tarifat dhe koston e shërbimit lidhet ngushtë edhe me mungesën e besimit që palët janë shprehur se kanë tek profesionalizmi dhe efienca e procesit të ndërmjetësimit dhe e marrëveshjes së ndërmjetësimit. Ky perceptim lidhet ngushtë me mundësinë e ofrimit të këtij shërbimi pa pagesë. Për këtë arsye, do të ishte e nevojshme që MD të kishte një parashikim ligjor për vlerësimin e mundësinë së ofrimit falas të këtij shërbimi për kategoritë në nevojë dhe posaçërisht për rastet e të miturve në konflikt me ligjin.

¹⁴ Disa nga ndërmjetësit e listës së publikuar nga DHKN të kontaktur nga intervistuesit nuk e ushtronin me veprimtarinë e ndërmjetësimit.

Për sa i përket impaktit të dispozitave të reja ligjore¹⁵, pavarësisht se kanë kaluar dy vite nga miratimi i tyre, nuk mund të thuhet që kanë prodhuar rezultate pozitive në rritjen e numrit të çështjeve që referohen nga gjykata/prokurori tek ndërmjetësimi dhe as në rritjen e numrit të përgjithshëm të mosmarrëveshjeve që zgjidhen me ndërmjetësim. Me ndryshimet e ligjit për ndërmjetësim me ligjin nr. 26/2018 u parashikua detyrimi për gjykatën ose organin përkatës shtetëror për të njoftuar, udhëzuar dhe, sipas rastit, informuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme palët për zgjidhjen me ndërmjetësim¹⁶. Nga përmbajta e kësaj dispozite lexohet një tendencë për t'i dhënë një karakter solid zbatimit të referimit tek ndërmjetësi. Megjithatë, pavarësisht terminologjisë së përdorur në ligj¹⁷ nuk mund të thuhet që ligji për ndërmjetësimin parashikon ndërmjetësimin e detyrueshëm sipas modeleve të ligjeve të vendeve të tjera që parashikojnë detyrimin që palëve tu kërkohet të marrin pjesë në një takim fillestar me një ndërmjetës, si kusht për tu plotësuar përpara se të zgjidhin mosmarrëveshjen gjyqësisht¹⁸. Një model i tillë është provuar të jetë një mjet efikas për të nxitur përdorimin e ndërmjetësimit në disa shtete¹⁹. Në lidhje me eventualitetin e zbatimit të referimit të detyrueshëm në legjislacionin shqiptar, gjyqtarët dhe prokurorët e intervistuar shprehen skeptikë, duke sjellë si argument natyrën vullnetare të këtij procesi, cenimin e të drejtave të individëve për t'iu drejtuar gjykatës si dhe tejzgjatjen e procesit gjyqësor në rast se çështja do të rikthehej në gjykatë. Këto arsye përkojnë tërësisht me ato që parashatrojnë gjyqtarët për të argumentuar mungesën aktuale të referimit nga ana e tyre të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis palëve me ndërmjetësim.

3.3 Efektiviteti i zbatimit të legjislacionit të ndërmjetësimit nga ndërmjetësit

Krahas perceptimit qytetar, monitorimit të seancave gjyqësore, me rëndësi në zbatimin e legjislacionit të ndërmjetësimit paraqet dhe vlerësimi i mënyrës së zhvillimit të këtij procesi. Rezultatet e anketimit me 12 individë pjesëmarrës në një proces ndërmjetësimi sugjerojnë se **përzgjedhja e ndërmjetësimit si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve është më e shpeshtë në grupmoshat 18-30 dhe 31-40 vjeç** se sa në grupmoshat e tjera, siç sugjeron grafiku më poshtë. Një rezultat i tillë është i shpjegueshëm ndër të tjera dhe me faktin se instituti i ndërmjetësimit është relativisht i ri,²⁰ qytetarët e moshave më të reja mund të shfrytëzojnë më shumë burime informacioni në lidhje me avantazhet e ndërmjetësimit si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve.

¹⁵ Ligj nr. 26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, miratuar në datën 17.5.2018;

¹⁶ Neni 2 i ligjit nr. 10385/2011;


¹⁷ “detyrimisht”;

¹⁸ ALTRI, Analizë e kuadrit ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim”, Shtator 2019, <https://altri.al/wp-content/uploads/2020/06/ANALIZ%C3%8B-LIGJORE-MBI-INSTITUTIN-E-NDERMJETESIMIT-SHTATOR-2019.pdf>, fq.54

¹⁹ p.sh Itali,Turqi dhe Serbi, zbatimi i këtij modeli ka rritur ndjeshëm numrin e mosmarrëveshjeve që zgjidhen me ndërmjetësim


²⁰ Ligji i parë i posaçëm për veprimtarinë e ndërmjetësimit përkon me ligjin nr. 8465, datë 11.3.1999, “Për ndërmjetësimin për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve.

Grafiku nr.18: Moshë e të anketuarve që kanë marrë pjesë në një proces ndërmjetësimi




Një aspekt pozitiv që duhet përmendur është se ndër rastet e monitoruara zbulohet një tendencë e rritur e **zbatimit të institutit të ndërmjetësimit në çështjet me karakter penal**. Nga anketimet e realizuara me individë pjesëmarrës në një proces ndërmjetësimi dhe të referuar nga gjykata/prokurori, 75% e të anketuarve kanë qenë në cilësinë e të pandehurit ose të miturit në konflikt me ligjin në procesin gjyqësor, 17% e tyre kanë qenë në cilësinë e paditësit dhe 8% në cilësinë e të paditurit. Këto të dhëna dëshmojnë se ndryshimet e reja ligjore në KPrP i kanë dhënë udhë ndërmjetësimit si alternativë në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji.

Grafiku nr.19: Në rast të referimit nga gjykata, prokurori, cilësia e individit në procesin gjyqësor




Nga anketimi i individëve pjesëmarrës në një proces ndërmjetësimi rezulton se **pak më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) kanë zgjedhur të mbrohen me avokat**, ndërsa 46% kanë zgjedhur të përfaqësohen vetë. Numri i konsiderueshëm i qytetarëve që mbrohen vetë, ndër të tjera, është tregues i kostove më të ulta financiare që kjo alternativë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve paraqet për qytetarin.

Grafiku nr.20: Mbrojtja gjatë një procesi ndërmjetësimi




Pjesa më e madhe e të anketuarve, në masën mbi 92%, shprehen se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me sqarimet e bëra nga ndërmjetësi për procesin e ndërmjetësimit, si dhe sjelljen e tij gjatë këtij procesi. Po në të njëjta nivele, paraqiten dhe të dhënat në lidhje me mundësinë akorduar palëve nga ndërmjetësi për të parashtruar opinione dhe për të sjellë prova.


Grafiku nr.21: Niveli i kënaqshmërisë së palëve në një proces ndërmjetësimi lidhur me sqarimet e bëra nga ndërmjetësi për procesin e ndërmjetësimit



Grafiku nr.22: Niveli i kënaqshmërisë së palëve në një proces ndërmjetësimi lidhur me sjelljen e ndërmjetësit gjatë këtij procesi




Grafiku nr.23: Niveli i kënaqshmërisë së palëve në një proces ndërmjetësimi lidhur me mundësinë që u është dhënë që të shprehin opinionet e tyre dhe të paraqesin prova




Për sa i përket nivelit të përgatitjes profesionale të ndërmjetësve, rezultatet nga grafiku paraqiten disi më të diversifikuara. Individët janë shprehur në **92% të rasteve se kanë dalë shumë të kënaqur ose të kënaqur nga procesi i ndërmjetësimit, ndërsa në 8% të rasteve kanë dalë as të kënaqur/as të pakënaqur**. Në përcaktimin e vlerësimit të të anketuarve për nivelin e shërbimit të ofruar nga ndërmjetësi, duhet mbajtur parasysh se subjektet që janë anketuar janë referuar nga ndërmjetësit. Për pasojë, do të mbahet në konsideratë një tendencë e shtuar drejt vlerësimit pozitiv të performancës së ndërmjetësve.

Grafiku nr.24: Niveli i kënaqshmërisë së palëve në një proces ndërmjetësimi lidhur me përgatitjen profesionale të ndërmjetësit



Përpos profesionalizmit dhe sjelljes së ndërmjetësve, rezulton se ka disa faktorë të tjerë që ndikojnë në përzgjedhjen e kësaj mënyre të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Faktorët e marrë në analizë janë kostoja e procesit, koha e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe kompleksiteti i çështjeve objekt ndërmjetësimi. Në lidhje me kostot, kur janë pyetur mbi tarifat e shërbimit të ndërmjetësimit janë shprehur si në grafikun më poshtë:


Grafiku nr.25: Niveli i kënaqshmërisë së palëve në një proces ndërmjetësimi lidhur me tarifat e ndërmjetësimit



Afërsisht **50% e të anketuarve janë shprehur se kanë qenë të kënaqur**, vetëm 8% e tyre kanë qenë shumë të kënaqur, ndërsa **42% janë shprehur se nuk janë as të kënaqur as të pakënaqur**. Këto rezultate flasin për një numër të lartë të qytetarëve që janë shprehur as të kënaqur dhe as të pakënaqur nga tarifa. Nga këto të dhëna lexohet një hezitim i ndjeshëm për të mos qenë dakord me nivelin e tarifave që janë aplikuar. Megjithatë, lidhur me këto të dhëna duhet marrë në konsideratë që shumica e të anketuarve janë shprehur në cilësinë e të miturit në konflikt me ligjin (në momentin e kryerjes së veprës penale). Një aspekt problematik i konstatuar dhe i trajtuar në këtë raport është mungesa e rregullimit të tarifave, detyrim i cili buron nga neni 7 pika d e ligjit. Sipas kësaj dispozite, këto tarifa propozohet nga DHKN dhe miratohen me udhëzim të përbashkët midis Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, i cili ende nuk është miratuar. Përpos këtij udhëzimi, ligji nuk parashikon mundësi të përjashtimit nga detyrimi i pagimit të tarifës së shërbimit ose lehtësimit të kësaj tarife në procedurën e ndërmjetësimit në rastet e të miturit në konflikt me ligjin, i ngritur si shqetësim edhe nga gjyqtarët dhe prokurorët.


Për sa i përket kohës së përfundimit të procesit, në **50% të rasteve të anketuarit janë shprehur shumë të kënaqur në lidhje me kohën e arsyeshme të përfundimit të procesit të ndërmjetësimit**, në 33.33% të rasteve janë shprehur të kënaqur, ndërsa në 16.67% të rasteve janë shprehur relativisht të pakënaqur duke arsyetuar se procesi i ndërmjetësimit duhet të kishte pasur një zgjidhje më efektive dhe më të shpejtë në mënyrë që të përmbushte pritshmëritë e tyre.

Grafiku nr.26: Niveli i kënaqshmërisë së palëve në një proces ndërmjetësimi lidhur me kohën e përfundimit të procesit të ndërmjetësimit




Kompleksiteti i çështjeve gjithashtu është një aspekt i çështjeve që mund të paragjykojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. Konkretisht, nga të dhënat nga intervistat me personat që i janë nënshtruar një procesi ndërmjetësimi rezulton se **në 92% të rasteve ndërmjetësimi e ka zgjidhur mosmarrëveshjen plotësisht** ndërsa në 8% të rasteve ka zgjidhur vetëm një pjesë të mosmarrëveshjes. Duke qenë se vetëm në një pjesë shumë të vogël e rasteve mosmarrëveshja është zgjidhur pjesërisht, rezulton se palët do të duhet të zgjidhin elementë të tjerë të mosmarrëveshjes përmes mënyrave të tjera, përfshirë këtu dhe zgjidhjen në rrugë gjyqësore.

Grafiku nr.27: Pyetje: “A u zgjidh përfundimisht çështja nëpërmjet ndërmjetësimit?”



Së fundmi, individët palë në një proces ndërmjetësimi janë pyetur nëse do të zgjidhnin sërish ndërmjetësimin për mosmarrëveshjet që mund të kenë të ardhmen. Në **83% të rasteve të anketuarit janë shprehur se do të aplikojnë përsëri në të ardhmen këtë institut për të zgjidhur mosmarrëveshjet**, ndërsa 17% janë shprehur të pasigurt.

Grafiku nr.28: Pyetje: “A do ta përdornit sërish ndërmjetësimin si një mjet për të zgjidhur mosmarrëveshjet?”



Nga analiza e të dhënave të përpunuara më sipër rezulton se në më shumë se 90% të rasteve të shqyrtuara përmes ndërmjetësimit, janë referuar nga gjykatat, duke dëshmuar edhe një herë rëndësinë thelbësore që mbart mekanizmi i referimit nga gjykatat. Individët e anketuar ndajnë opinione pozitive në lidhje me faktorë të tillë si profesionalizmi, sjellja, mënyra e zhvillimit të procesit nga ndërmjetësit. Ndërsa për sa i përket tarifave të aplikuara një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë zgjedhur të mos prononcohen. Për sa i përket kohës dhe mënyrës së zgjidhjes me ndërmjetësim, qytetarët shprehen të kënaqur.

4. Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Në vijim të konstatimeve të mësipërme që rrjedhin nga procesi i monitorimit dhe anketimit gjetjet kryesore mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Niveli i njohurive të të anketuarve në lidhje me ndërmjetësimin është i ulët, pasi afërsisht 2/3 e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë informacion në lidhje me këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
2. Informacioni në lidhje me ndërmjetësimin merret kryesisht përmes medias/internetit dhe në një masë më të vogël nga gjykata që shqyrton çështjen;
3. Në pothuajse 2/3 e procesve gjyqësore të monitoruara gjyqtarët nuk kanë përmendur mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim;
4. Kur gjyqtarët informojnë palët në lidhje me ndërmjetësimin, në shumicën e rasteve mjaftohen vetëm duke e përmendur këtë mundësi, pa adoptuar një qasje proaktive në parashtrimin e avantazheve procedurale, kohore dhe financiare të ndërmjetësimit;
5. Pothuaj 75% e të anketuarve nuk do të zgjidhnin ndërmjetësimin edhe nëse i sugjerohej nga gjyqtari ndërkohë që edhe gjyqtarët vërejnë një tendencë nga palët për refuzuar mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në rastet kur ato njoftohen/udhëzohen nga gjyqtarët lidhur me këtë procedurë;
6. Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se ndërmjetësimi është një mekanizëm që vetëm do të zvarrisë procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, ose do të ketë kosto të shtuara, dhe një pjesë e tyre nuk kanë besim në profesionalizmin, konfidencialitetin si dhe paanësinë e ndërmjetësit;
7. Gjyqtarët, prokurorët dhe ndërmjetësit konstatojnë mungesë të besimit nga palët tek fuqia zbatuese e marrëveshjes së ndërmjetësimit dhe nëse pala tjetër do i qëndrojë kësaj

- marrëveshjeje, çfarë mund të sjellë si pasojë zgjatjen e procesit gjyqësor dhe shpenzime shtesë për palën;
8. Të anketuarit, gjyqtarët dhe prokurorët e intervistuar shprehen gjithashtu se në disa raste avokatët u këshillojnë palëve zgjidhjen e çështjeve në rrugë gjyqësore me qëllim garantimin në vijimësi të ofrimit të shërbimit të mbrojtjes ligjore;
 9. Kostot e ndërmjetësimit konsiderohen nga gjyqtarët dhe prokurorët si të papërballueshme, kryesisht nga ana e familjarëve të të miturve në konflikt me ligjin. Individët e anketuar që kanë marrë pjesë në një proces ndërmjetësimi shprehen vetëm pjesërisht të kënaqur me tarifat. Mungesa e një tavani, lehtësimi ose subvencionimi të tarifave për grupet në nevojë mund të përbëjë një faktor që ndikon në mospërzgjedhjen e ndërmjetësimit si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
 10. Niveli profesional i ndërmjetësve vlerësohet jo në nivelet e duhura dhe mungojnë trajnimet vazhduese të ndërmjetësve dhe promovimi i duhur nga DHKN;
 11. Gjyqtarët dhe prokurorët e konsiderojnë përgjithësisht referimin e palëve tek ndërmjetësimi si një veprim paragjykses ndaj çështjes, që cënon të drejtën e palëve për t'iu drejtuar gjykatës.
 12. Gjyqtarët nuk e konsiderojnë mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim si avantazh pasi shoqërohet me tejzgjatje të procesit në kohë dhe shpenzime shtesë;
 13. MD dhe DHKN nuk kanë vënë në dispozicion të publikut, gjyqtarëve dhe prokurorëve një liste të përditësuar të ndërmjetësve si dhe nuk kanë siguruar profilizimin e tyre sipas fushave të së drejtës ku ofrohet ndërmjetësimi duke i dhënë prioritet profilizimit të ndërmjetësve që trajtojnë çështjet e të miturve në konflikt me ligjin;
 14. Shpërndarja gjeografike e ndërmjetësive që ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit është problematike, pasi shumica e ndërmjetësve të licencuar e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë duke sjellë kështu kufizim të aksesit të qytetarëve në këtë shërbim;
 15. Dispozitat e reja ligjore, pavarësisht se kanë kaluar dy vite nga miratimi i tyre, nuk kanë prodhuar rezultate pozitive në rritjen e numrit të çështjeve që referohen nga gjykata/prokurori tek ndërmjetësimi dhe as në rritjen e numrit të përgjithshëm të mosmarrëveshjeve që zgjidhen me ndërmjetësim;
 16. Të anketuarit në grupmoshat 18-30 dhe 31-40 vjeç janë më të prirur të zgjedhin ndërmjetësimin si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
 17. Individët e anketuar që e kanë përdorur shërbimin e ndërmjetësimit, shprehen shumë të kënaqur ose të kënaqur me këtë mënyrë zgjidhjeje të mosmarrëveshjeve dhe me mënyrën e ofrimit të shërbimeve nga ndërmjetësi;
 18. Në 83% të rasteve, qytetarët e anketuar që i janë nënshtruar një procesi ndërmjetësimi do të zgjidhnin sërish ndërmjetësimin si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tyre.

5. Rekomandime

Bazuar në gjetjet e mësipërme, në vijim do të ofrohen disa rekomandime që do të kenë për qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe rritjen e numrit të rasteve të referuara nga gjykatat/prokurorët:

1. Ndërmarrja e fushatave të gjera ndërgjegjëse dhe promovuese nga MD dhe DHKN me qëllim përçimin e informacionit për avantazhet procedurale, kohore, dhe financiare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim në një gjuhë të përshtatshme dhe kuptueshme për individët e të gjitha moshave, niveleve arsimore, si në zonat rurale dhe ato urbane.
2. Parashikimi në Ligjin Nr. 10385 datë 24.02.2011 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim”(i ndryshuar) i referimit të detyrueshëm nga gjyqtari/prokurori për realizimin e një takimi paraprak me ndërmjetësin, përpara se të nisë shqyrtimi gjyqësor, sidomos për kategori të vecanta çështjesh gjyqësore, veçanërisht në rastet e padive me vlerë të vogël dhe proceset gjyqësore me subjekt të mitur në konflikt me ligjin;
3. Parashikimi i mekanizmave për mbikqyrjen nga KLGJ dhe KLP të zbatimit të detyrimit ligjor për referimin nga gjyqtarët dhe prokurorët duke e përfshirë në sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
4. Publikimi nga MD dhe DHKN i udhëzimit të përbashkët midis Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave për tarifat e shërbimit të ndërmjetësimit si dhe parashikimi ligjor i mundësisë së përjashtimit nga tarifa ose reduktimit të tarifës për subjekte që u përkasin grupeve në nevojë;
5. Në formularin që i vihet në dispozicion të pandehurit/personit nën hetim/të miturit në konflikt me ligjin të shtohet edhe parashikimi i mundësisë së zgjidhjes me ndërmjetësim, kur kjo e fundit është e mundur të aplikohet;
6. Organizimi i trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe njohjen me praktikën më të mira në lidhje me referimin e rasteve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. Nëpërmjet trajnimeve duhet të mundësohet informimi i thelluar me avantazhet dhe qasjen e re që paraqesin ndryshimet ligjore të Ligjit Nr. 10385 datë 24.02.2011 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim”(i ndryshuar) në drejtim të rritjes së angazhimit të tyre proaktiv në njoftimin dhe orientimin e palëve për mundësitë e shërbimit të ndërmjetësimit, avantazhet dhe kostot dhe garantimin e një aksesimi sa më efektiv të qytetarëve në drejtësi.
7. Ndërmarrja e hapave konkrete nga DHKN për profilizimin e ndërmjetësve, me fokus të veçantë ndërmjetësit që angazhohen në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me subjekte të mitur në konflikt me ligjin;
8. Zhvillimi në mënyrë periodike i trajnimeve të ndërmjetësve me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre profesionale, prezantimin me metodat efektive bashkëkohore, në funksion të rritjes së besimit të qytetarëve tek kjo mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
9. Lidhja e një marrëveshje bashkëpunimi midis DHKN dhe DHASH për ngritjen e urave të bashkëpunimi midis dhomave për koordinimin dhe orientimin e rasteve që mund të orientohen drejt zgjidhjes me ndërmjetësim;
10. Zhvillimi i takimeve të përbashkëta midis KLGJ, KLP, DHKN, DHASH me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë promovuese të këtij instituti përmes miratimit të

udhëzuesve të përbashkët që detajojnë parashikimet ligjore dhe që lehtësojnë proceduralisht shfrytëzimin e institutit të ndërmjetësimit;

11. Kontrolli periodik i ushtrimit të veprimtarisë dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit nga ndërmjetësit me integritet dhe profesionalizëm përmes inspektimeve nga MD;
12. Vlerësimi i mundësisë së përfshirjes së klinikave të ligjit në fakultete dhe pedagogëve ndërmjetës në proceset e ndërmjetësimit të referuara nga gjykata ose me nismën e palëve, me qëllim rritjen e profesionalizimit dhe besueshmërisë në ofrimin e këtij shërbimi ndaj qytetarëve.

SHTOJCA NR.1 METODOLOGJIA DHE FORMULARI I MONITORIMIT TË SEANCAVE GJYQËSORE

I. Objekti i metodologjisë

Metodologjia e monitorimit në gjykata është bazuar në objektivat e projektit "*Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme!*", zbatuar nga Qendra ALTRI me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, dhe është hartuar në përputhje me gjetjet e analizës së ligjore dhe vështirimit krahasues të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. Monitorimi i seancave gjyqësore do të përqendrohet në zbatimin e dispozitave të KPrC, KPrP, Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligjit 10385, datë 24.2.2011, "*Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*" (i ndryshuar) lidhur me **detyrimin për njoftim nga gjykata** dhe **udhëzimin e palëve** për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve.

Objekti i metodologjisë së monitorimit në gjykata është që përmes mbledhjes së të dhënave të synohet të nxirren përfundime mbi:

- Impaktin e ndryshimeve në legjislacion lidhur me ndërmjetësimin e referuar nga gjykata;
- Nivelin e zbatimit të detyrimit të njoftimit/udhëzimit/informimit të palëve mbi shërbimin e ndërmjetësimit dhe të referimit të rasteve nga gjykatat për të orientuar individët/palët në zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve të tyre.

Procesi të monitorimit do t'i paraprijë një seancë trajnuese me monitoruesit të cilët do të udhëzohen mbi procesin e monitorimit dhe anketimit. Përgjatë gjithë procesit të monitorimit, monitoruesit do të asistohen nga ekspertët e projektit me qëllim qartësimin si dhe unifikimin e praktikave. Ata do të vendosen në një platformë komunikimi të përbashkët nëpërmjet e-mailit, skype dhe whatsapp-it në mënyrë që të shkëmbehen informacionet, pyetjet dhe sugjerimet në kohë reale.

II. Përqatitja dhe planifikimi i procesit të monitorimit

Procesi i monitorimi do të zhvillohet brenda një periudhe 3 mujore (120 ditë monitorimi: *10 ditë monitorimi në muaj, ose 30 ditë monitorimi në total për secilin monitorues, në total 30 ditë monitorimi *4 gjykata=120 ditë monitorimi*), pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Korçës. Procesi do të nisë në Dhjetor 2019 dhe do të përfundojë në Shkurt 2020. Përmes një shkrese ALTRI ka informuar gjykatat lidhur me nisjen e procesit të monitorimit ka kërkuar gjithashtu dhe bashkëpunimin e tyre për të siguruar mbarëvajtjen e këtij procesi.

Planifikimi i procesit të monitorimit do të realizohet përmes përzgjedhjes së çështjeve në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykata, sipas publikimit në sistemet ICMIS dhe PAKS, duke marrë në konsideratë se publikimi i seancave realizohet për një periudhë dy javore përpara zhvillimit të tyre. Kalendari i seancave për Gjykatat e Rretheve Gjyqësore gjendet në faqet e internetit si vijon:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	http://gjykatatirana.gov.al/
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër :	http://www.gjykata.gov.al/rrethi-shkod%C3%ABr/gjykata-e-rrethi-shkod%C3%ABr/kalendari-i-seancave/
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	http://www.gjykata.gov.al/rrethi-vlor%C3%AB/gjykata-e-rrethi-vlor%C3%AB/kalendari-i-seancave/
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë:	http://www.gjykata.gov.al/rrethi-korc%C3%AB/gjykata-e-rrethi-korc%C3%AB/kalendari-i-seancave/

Në rastet e mosfunksionimit të sistemit ICMIS dhe PAKS, ALTRI do të kontaktojë drejtpërdrejtë me kancelarët e gjykatave dhe do të realizojë njoftimin në kohën sa më të shpejtë të monitoruesve.

Kriteret që janë marrë parasysh për shpërndarjen e ngarkesës dhe përzgjedhjen e numrit të seancave në gjykata janë:

- Numri i seancave gjyqësore në një ditë në gjykatë;
- Ngarkesa e gjykatave, duke i akorduar volumin më të madh të monitorimit çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Ngarkesën maksimale që mund të përballojë një monitorues në ditë (deri në 4 seanca, duke marrë në konsideratë vonesat dhe zvarritjet e mundshme të procesve gjyqësore dhe mundësinë e aksesit në mjediset e gjykimit)²¹;
- Monitorimin në të njëjtën kohë në të gjitha gjykatat;
- Natyra e çështjeve në monitorim.

Në përputhje me sa më sipër, parashikohet se do të monitorohen në total 600 seanca gjyqësore. Duke qenë se në bazë të statistikave të publikuara nga Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë Gjykata e Shkallës së parë Tiranë ka një numër shumë më të madh çështjesh të regjistruara në vit, që arrijnë nga 5.9 herë deri në 14 herë më të lartë se gjykatat e tjera objekt monitorimi, numri i seancave të monitoruara në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë do të jetë së 2 herë më lartë se në gjykatat e tjera.²²

Bazuar në këtë ndarje, në një gjykatë përgjatë një periudhe monitorimi (30 ditë monitorimi për gjykatë) parashikohen të monitorohen seancat si vijon:

- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë:
 - 50 çështje familjare në seancë përgatitore ose gjatë procesit gjyqësor
 - 20 çështje civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve;
 - 120 çështje civile në seancë përgatitore ose gjatë procesit
 - 50 çështje penale.

²¹ Rishikimi i këtij parashikimi në metodologji është bërë në vijim të gjetjeve të javës së pilotimit të metodologjisë në gjykata.

²² Ministria e Drejtësisë Vjetari Statistikor 2018, Numri i çështjeve gjyqësore civile dhe penale të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë është 33 827, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është 5,681 , në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë është 2,391 , dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër është 4,256, fq.13, <https://drejtesia.gov.al/ëëëëëp-content/uploads/2019/07/Vjetari-Statistikor-2018-PDF.pdf>

Gjithësej 240 çështje, 2 monitorues të angazhuar, rreth 4 çështje në ditë.

- Për secilën nga gjykatat e rretheve gjyqësore Korçë, Vlorë, Shkodër
 - 30 çështje familjare në seancë përgatitore ose gjatë procesit gjyqësor
 - 10 çështje civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve;
 - 50 çështje civile në seancë përgatitore ose gjatë procesit
 - 30 çështje penale.

Gjithësej 120 çështje për secilën gjykatë, 3 monitorues të angazhuar, rreth 4 çështje në ditë.

Ndarja e çështjeve sipas seancave gjyqësore është një parashikim dhe objekti/faza e gjykimit të çështjeve mund të ndryshojë në varësi të seancave gjyqësore që do të zhvillohen gjatë periudhës në monitorim.

Shpërndarja e planit të monitorimit dhe përzgjedhjes së çështjeve në gjykatat do të jetë objekti rishikimi nga ekspertët e ALTRI çdo javë me qëllim përshtatjen e këtij plani me vështirësitë e hasura në zbatim. ALTRI do të koordinojë procesin e njoftimit të monitoruesve, pajisjen e tyre me bazën materiale të nevojshme për monitorim.

III. Kriteret për përzgjedhjen e llojit të seancave gjyqësore

Përzgjedhja e seancave gjyqësore do të realizohet në përputhje me parashikimet e ligjit 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” (i ndryshuar), Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Objekt i monitorimit do të jenë çështjet e regjistruara në gjykata pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore në ligjin për ndërmjetësimin, miratuar më datë 17.05.2018 si dhe dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për këto qëllime, do të merren në konsideratë për qëllime monitorimi çështjet e regjistruara në gjykata pas datës 1 qershor 2018.

Në lidhje me përzgjedhjen e çështjeve civile, për qëllime të monitorimit do të zgjidhen paditë nga seksioni “Padi të tjera kontraktuale” me qëllim evidentimin e padive të cilat janë ose padi me vlerë të vogël në përputhje me nenin 162/a të Kodit të Procedurës Civile²³ kur ato zhvillohen në seancë gjyqësore si edhe padi të tjera civile për të cilat, në varësi edhe të rrethanave të çështjes mund të konsiderohen më të përshtatshme për t’u zgjidhur me ndërmjetësim.

Për sa i përket çështjeve familjare do të përzgjidhen ato çështje ku baza ligjore janë nenet 66 (marrëveshja për regjimin pasuror martesor), 125 (zgjidhja e martesës me marrëveshje), 134-136 (pajtimi për zgjidhjen e martesës), dhe 221 (konfliktet për fëmijën) të Kodit të Familjes.

Në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, çështjet objekt gjykimi do të jenë ato të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe

²³ Kodi i Procedurës Civile Neni 162/a para 1 “1. Paditë me vlerë deri në 150 000 lekë, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, shqyrtohen nga gjykata me gjykim të shkurtuar. “

254 të Kodit Penal, të cilat janë vepra penale të iniciuara nga viktimat akuzuese. Ndër këto çështje do të synohet të përzgjidhen dhe çështje me palë të mitur në konflikt me ligjin si dhe viktimën akuzuese, me qëllim monitorimin e zbatimit të nenit 63 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.²⁴

IV. Monitorimi i drejtpërdrejtë në gjykatë

Monitorimi në gjykata do të realizohet nga monitoruesit pasi të jenë pajisur me bazën logjistike për monitorimin. Të gjitha të dhënat e monitorimit do të hidhen në formular monitorimi i cili do t'u bëhet i njohur monitoruesve i cili gjendet i pasqyruar në Aneksin 1. Monitorimi do të kryhet në mjediset e gjykatave respektive dhe pjesëmarrja në seanca gjyqësore do të bëhet përmes akomodimit në mjedisin e rezervuar për publikun.

V. Detyrimet e monitoruesëve

Përgjatë gjithë zhvillimit të veprimtarisë monitoruese dhe deri në përfundim të saj, monitoruesit duhet të përmbushin detyrimet si më poshtë:

1. Monitoruesit e zhvillojnë veprimtarinë e tyre me integritet të lartë, përgjegjshmëri si dhe ndershmëri në përputhje me kuadrin metodologjik të miratuar të këtij studimi si dhe kuadrin ligjor në fuqi.
2. Monitoruesit ruajnë etikën në marrëdhëniet me gjyqtarët, palët ndërgjyqëse, stafin administrativ në gjykata si dhe duhet të trajtojnë këta të fundit me respekt.
3. Monitoruesit respektojnë rregullat e paraqitjes në gjykatë, të marrin masa që të paraqiten në kohë, pajisur me mjet identifikimi si dhe me veshje të përshtatshme.
5. Monitoruesit duhet të garantojnë konfidencialitetin e të dhënave të mbledhura si gjatë procesit të monitorimit .
6. Monitoruesit duhet të respektojnë udhëzimet e dhëna nga ekspertët e projektit në lidhje me mënyrën e zhvillimit të monitorimit si dhe të tregojnë fleksibilitet për t'iu përshtatur kërkesave që synojnë mbarrëvajtjen e procesit të monitorimit.

VI. Raportimi dhe përpunimi i të dhënave

Me përfundimin të çdo jave monitorimi, monitoruesi do të dorëzojë pranë ALTRI formularët e monitorimit. Këto formularë do të sistematizohen duke u hedhur në kompjuter me qëllim përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultateve statistikore dhe cilësore të monitorimit.

²⁴ Ligj 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur” Neni 63 “Programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi

Formular monitorimi

Projekti “Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme”

	Të dhënat nga monitorimi			
Data dhe ora e seancës së monitoruar	____.____.____		Ora : ____:____	
Emri i gjyqtarit/gjyqtarës				
Objekti i gjykimit dhe baza ligjore	Objekti:		Ligji/Kodi____ Neni_____	
Lloji i procesit	Civil ☐	Penal ☐	Familjar ☐	
Lloji i seancës	☐ Përgatitore		Seancë gjyqësore ☐	
A është përmendur nga gjykata mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?	PO ☐		JO ☐	
A i informoi gjykata palët mbi avantazhet e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?	PO ☐		JO ☐	
A është kërkuar nga një nga palët në proces zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?	PO ☐	JO ☐	Nga të dyja palët ☐	
Reagimi i palëve ndaj propozimit të gjyqtarit për zgjidhjen me ndërmjetësim	Pranim ☐	Pranim pjesërisht ☐	Refuzim ☐	Nuk u propozua ☐ nga gjyqtari

SHTOJCA NR.2 METODOLOGJIA DHE PYETËSORËT

I. Metodologjia e anketimit

Anketa zhvillohet në kuadër të projektit "*Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme!*", zbatuar nga Qendra ALTRI me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, i cili ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe rritjen e numrit të rasteve të referuara nga gjykatat/prokurorët nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme.

Qëllimi i këtij anketimi është të mbledhë të dhëna cilësore dhe sasiore në mënyrë që t'u japë përgjigje pyetjeve si më poshtë:

- Cili është niveli i njohurive të palëve që i drejtohen gjykatës lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim?
- Cili është perceptimi i tyre lidhur me këtë shërbim?
- Si e vlerësojnë palët që kanë zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre me ndërmjetësim, shërbimin e ofruar?

Për qëllime të projektit do të realizohen 1000 anketa, 250 për secilin qytet, përkatësisht në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë me:

- ✓ palë që janë aktualisht në një proces gjyqësor (duke mbajtur në konsideratë objektin e çështjes);
- ✓ individë që kanë përfituar nga shërbimi i ndërmjetësimit;
- ✓ individë që i drejtohen gjykatës në kuadër të shërbimeve që ofron gjykata apo për të regjistruar një çështje gjyqësore.

Për këtë qëllim, në çdo gjykatë do të realizohen 250 anketa me individët e sipërpërmendur duke synuar diversifikimin e grupit të të anketuarve për të garantuar një balancë gjinore dhe përfaqësim moshor nga grupmosha të ndryshme. Gjithashtu, të gjithë të anketuarve do t'u kërkohej që të nënshkruajnë një deklaratë për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Plotësimi i pyetësorëve do të bëhet në ambientet e gjykatave për palët në proces gjyqësor, ndërkohë që për qytetarët që kanë përfituar ose përfitojnë nga shërbimi i ndërmjetësimit do të bashkëpunohet me ndërmjetësit dhe organizata që veprojnë në këtë fushë për identifikimin e tyre. I gjithë procesi do të realizohet nga 4 anketues të trajnuar paraprakisht nga ekspertët e ALTRI. Anketa do të pilotohet në mjediset e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për 2 javë, me 10 individë/palë të përzgjedhura. I gjithë procesi i anketimit do të zhvillohet në tre muaj.

II. Detyrimet e anketuesit

Përgjatë zhvillimit të anketës, anketuesit duhet të ushtrojnë detyrën e tyre në përputhje me sa më poshtë:

1. Të zhvillojnë veprimtarinë e tyre me integritet të lartë, përgjegjshmëri si dhe ndershmëri në përputhje me kuadrin metodologjik të miratuar të këtij studimi si dhe kuadrin ligjor në fuqi;
2. Të ruajnë etikën në marrëdhëniet me subjektet që do të anketohen si dhe duhet të trajtojnë këta të fundit me respekt dhe në mënyrë jo diskriminuese;
3. Të marrin masa për të tu pajisur në kohë me bazën materiale të anketimit nga ALTRI;
4. Të informojë kurdoherë subjektin e anketuar mbi identitetin e tij, organizatën që realizon studimin, si dhe qëllimet e studimit;
5. Të informojë subjektin e anketuar për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave sipas legjislacionit në fuqi dhe t'i kërkojë plotësimin e formularit për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale;
6. Të informojë subjektin se pyetësi është anonim dhe të gjitha të dhënat e mbledhura do të prezantohen vetëm në formë grupi dhe do të përdoren vetëm për qëllimet e këtij projekti;
7. Gjatë procesit të intervistimit të sigurohen se pyetja është kuptuar drejt nga të anketuarit dhe të sqarojnë përmbajtjen e pyetjes të anketuarve, nëse kërkohet prej tyre;
8. Të ruajnë me rigorozitet konfidencialitetin e të gjithë të dhënave të mbledhura përgjatë procesit të anketimit;
9. Të raportojnë rezultatet bazuar në parimin e paanësisë dhe të pa ndikuar nga subjekte të tretë;

Pyetësor për individët/palë në procese gjyqësore

Pyetësor N°

--	--

1 . Moshë: ☐18-30 ☐31-40 ☐41-50 ☐51-60 ☐Mbi 60

2. Gjinia: ☐ Femër ☐ Mashkull ☐ Nuk përcaktohet

3. Vendbanimi: _____

4. Niveli i arsimit: ☐ I mesëm ☐ Universitar ☐ Pasuniversitar ☐ Nuk dua të deklaroj

5. Cilësia e individit në procesin gjyqësor ose kundrejt gjykatës:

☐ Paditës ☐ I paditur ☐ I pandehur/I mitur në konflikt me ligjin ☐ Viktimë akuzuese

☐ Përfitues i shërbimeve (specifiko _____)

6. Keni informacion mbi ndërmjetësimin si mënyrë e zgjidhjet së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës?

☐ PO ☐ JO

7. Nëse po, nga e keni marrë informacionin për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim²⁵?

- ☐ Pala tjetër ndërgjyqëse
- ☐ Avokati juaj
- ☐ Gjykata
- ☐ Familjar ose mik
- ☐ Media/Internet
- ☐ Fletëpalosje
- ☐ Tjetër (specifiko _____)

8. A ju ka informuar gjyqtari për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?

☐ PO ☐ JO

9. Nëse po, cilin/cilët nga pohimet e mëposhtme përputhet me thëniet e gjyqtarit në seancë²⁶?

- ☐ Gjyqtari informoi për mundësinë e zgjidhjes me ndërmjetësim.
- ☐ Gjyqtari sqaroi avantazhet e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim
- ☐ Gjyqtari propozoi zgjidhjen me ndërmjetësim si zgjidhja më e mirë.

10. Nëse zgjidhja me ndërmjetësim do të parashtrohej/ishte parashtruar si mundësi nga gjyqtari, a do ta merrnit në konsideratë?

☐ PO ☐ JO

²⁵ Ju lutem shënoni aq zgjedhje sa janë të mundshme.

²⁶ Ju lutem shënoni aq zgjedhje sa janë të mundshme.

11 Nëse jo, cila është arsyeja/arsyet e refuzimit të ndërmjetësimit si mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve²⁷?

- ☐ Nuk kam besim tek paanësia e ndërmjetësit
- ☐ Nuk kam besim tek përgatitja profesionale e ndërmjetësit
- ☐ Nuk kam besim tek ruajtja e konfidencialitetit të procesit nga ndërmjetësi
- ☐ Do të zvarrisë procesin
- ☐ Mund të jetë më i kushtueshëm se procesi gjyqësor
- ☐ Tjetër (Specifiko _____)

Aneks 2 Pyetësor për individët që kanë shfrytëzuar shërbimin e ndërmjetësimit

Pyetësor nr.

--	--

1 . Moshë: ☐18-30 ☐31-40 ☐41-50 ☐51-60 ☐Mbi 60

2. Gjinia: ☐Femër ☐Mashkull ☐Nuk përcaktohet

3. Vendbanimi: _____

4. Niveli i arsimit: ☐I mesëm ☐Universitar ☐Pasuniversitar ☐Nuk dua të deklaroj

5. Referimi në procesin e ndërgjegjësimit:

☐ Vullnetar ☐ Referuar nga gjykata/prokurori

6. Në rast të referimit nga gjykata/prokurori, cilësia si palë në proces:

☐Paditës ☐I paditur ☐I pandehur/I mitur në konflikt me ligjin ☐Viktimë akuzuese

7. Jeni mbrojtur vetë apo me avokat gjatë procesit të ndërmjetësimit?

- ☐ Mbrojtur vetë
- ☐ Me avokat

8. Cila ka qënë shtysa fillestare për shfrytëzimin e shërbimit të ndërmjetësimit?

☐ Informacioni dhe udhëzimi i dhënë nga gjykata;

²⁷ Ju lutem shënoni aq zgjedhje sa janë të mundshme.

- ☐ Propozimi i palës tjetër ndërgjyqëse;
- ☐ Informacioni i marrë në rrugë të tjera (specifiko _____)
- ☐ Asnjë nga të treja (specifiko _____)

9. Nëse shtysa fillestare e shqyrtimit të çështes me ndërmjetësim ka ardhur nga gjyqtari/prokurori, cili/cilët nga pohimet e poshtme i konsideroni të vërteta²⁸?

- ☐ Gjyqtari informoi për mundësinë e zgjidhjes me ndërmjetësim;
- ☐ Gjyqtari informoi për mundësinë e zgjidhjes me ndërmjetësim dhe sqaroi avantazhet e kësaj mënyre të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- ☐ Gjyqtari propozoi ndërmjetësimin si mënyra më e mirë të të zgjidhur mosmarrëveshjen.

10. A u zgjidh përfundimisht çështja juaj përmes ndërmjetësimit?

- ☐ Po, u zgjidh
- ☐ Jo, nuk u zgjidh. Jemi detyruar t'i drejtohem gjykatës.
- ☐ Pjesërisht. Vetëm disa elementë të mosmarrëveshjes u zgjidhën me ndërmjetësim, por jo të gjitha.

11. A do ta përdornit sërish ndërmjetësimin si mjet për të zgjidhur mosmarrëveshjet?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

Në rast se jo, pse? specifiko _____

12. Ju lutem tregoni nga 1 në 5 sa të kënaqur keni qënë me shërbimin e ndërmjetësimit që ju është ofruar?

	1- Shumë i/e kënaqur	2- I/E kënaqur	3- As i/e kënaqur as i/e pakënaqur	4- I/E pakënaqur	5- Shumë i/e pakënaqur
Ndërmjetësi më sqaroi të gjitha aspektet e procesit të ndërmjetësimit përpara fillimit të procesit					

²⁸ Ju lutem shënoni aq zgjedhje sa janë të mundshme.

Sa të kënaqur keni qënë me përgatitjen profesionale të ndërmjetësit?					
Sa të kënaqur keni qënë me sjelljen e ndërmjetësit gjatë procesit?					
Gjatë procesit u është dhënë mundësia që të shprehni opinionet tuaja dhe të paraqisni prova?					
Sa të kënaqur keni qënë me kohën brenda të cilës përfundoi procesi i ndërmjetësimit ?					
Sa të kënaqur jeni me tarifat e vendosura ?					

SHTOJCA NR.4 METODOLOGJIA DHE INTERVISTAT

I. Metodologjia

Procesi i intervistimit realizohet në kuadër të projektit "*Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme!*", zbatuar nga Qendra ALTRI me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, i cili ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe rritjen e numrit të rasteve të referuara nga gjykatat/prokurorët nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme.

Qëllimi i intervistave me natyrë gjysëm të strukturuar me gjyqëtarët, prokurë dhe ndërmjetës është të nxjerrë disa konkluzione mbi:

1. Efektivitetin e dispozitave të reja të ligjit për ndërmjetësimin lidhur me referimin e rasteve nga gjykatat/prokurorët;
2. Zbatimin e deritanishëm të shërbimit të ndërmjetësimit;
3. Problematikat e hasura

Ky qëllim synohet të arrihet duke u dhënë përgjigje pyetjeve si më poshtë:

- Cilat kanë qenë problematikat e deritanishme që kanë cuar në zbatimin e kufizuar të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve?
- Si aplikohen dispozitat ligjore lidhur me referimin e rasteve të ndërmjetësimit nga gjykatat?
- Sa kanë ndikuar dispozitat e reja në rritjen e rasteve të ndërmjetësimit të referuara nga gjykatat? Cfarë problematikash paraqesin parashikimet ligjore të referimit tek ndërmjetësimi, nga gjykata apo prokurori, sipas dispozitave të reja të ligjit për ndërmjetësimi dhe Kodeve Procedurale?
- Sa eficiente konsiderohen këto dispozita nga gjyqtarët, prokurorët dhe ndërmjetësit?
- Cilat çështje konsiderohen si më të përshtatshme për tu zgjidhur me ndërmjetësim?
- Sa efektive kanë qenë marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura midis DHKN dhe gjykatave?

Për qëllime të tërheqjes së të dhënave sa më të plota lidhur me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni procedural civil dhe penal dhe ai specifik për ndërmjetësimin do të jenë 60 të intervistuar, ose 15 për secilin qytet (përafërsisht 5 gjyqtarë, 5 prokurorë, 5 ndërmjetës) duke mbajtur në konsideratë natyrën e çështjeve që trajtojnë si dhe nëse kanë referuar apo jo raste ndërmjetësimi. Për të gjithë të intervistuarit do të mbahen të dhëna mbi identitetin e tyre, gjykatën/prokurorinë pranë të cilës ushtrojnë funksionet e tyre. Të dhënat e mbledhura nga procesi i intervistimit do të përpunohen nga ekspertët e ALTRI dhe do të interpretohen duke i krahasuar me gjetjet nga monitorimi i gjykatave dhe procesi i anketimit. Gjatë këtij procesi, intervistuesit e ALTRI kryejnë me rigorozitet dhe ndershmëri procesin e intervistimit dhe respektojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Intervista me gjyqtarë

1. A i informoni palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?
2. Ai i përmendni palëve avantazhet e dhe pasojat ligjore të ndërmjetësimit dhe karakterin vullnetar të këtij procesi, apo kufizoheni vetëm tek informimi i mundësisë së ndërmjetësimit?
3. Përgjithësisht, në cilën fazë të gjykimit u jeni drejtuar palëve për tu propozuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?
4. Në rast se palët kanë refuzuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, cilat kanë qenë arsyet (nëse janë bërë të ditura gjatë procesit)?
5. Cilat kategori çështjesh i konsideroni si më të përshtatshme për tu zgjidhur me ndërmjetësim?
6. Sa efikënte i vlerësoni dispozitat e reja ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim? Cilat janë boshllëqet?
7. Mendoni se për të rritur efikëncën e zbatimit duhet të parashikohet referimi i detyrueshëm nga gjykatat për një takim fillestar me ndërmjetës përpara se të nisë procesi gjyqësor?
8. Cilat mendoni se kanë qenë problematikat e deritanishme që kanë çuar në zbatimin e kufizuar të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve?

Intervista me prokurorë

1. A i informoni palët (të pandehurin/ të miturin në konflikt me ligjin/ viktimën akuzuese) për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim për vepra penale sipas dispozitave KPrP?
2. A u përmendni palëve avantazhet e dhe pasojat ligjore të ndërmjetësimit dhe karakterin vullnetar të këtij procesi, apo kufizoheni vetëm tek informimi i mundësisë së ndërmjetësimit?
3. Në rast se palët kanë refuzuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, cilat kanë qenë arsyet (nëse janë bërë të ditura gjatë procesit)?
4. Cilat kategori çështjesh i konsideroni si më të përshtatshme për tu zgjidhur me ndërmjetësim?
5. Sa efikënte i vlerësoni dispozitat e reja procedurale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim? Cilat janë boshllëqet?
6. Mendoni se për të rritur efikëncën e zbatimit duhet të parashikohet referimi i detyrueshëm për një takim fillestar me ndërmjetës përpara se të nisë procesi gjyqësor?

7. Cilat mendoni se kanë qenë problematikat e deritanishme që kanë cuar në zbatimin e kufizuar të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve?

Intervista me ndërmjetës

1. Cilat mendoni se kanë qenë problematikat e deritanishme që kanë cuar në zbatimin e kufizuar të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve?

2. Sa efçente i vlerësoni dispozitat e reja të Ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim? Cilat janë boshllëqet?

3. Sa kanë ndikuar dispozitat e reja në rritjen e rasteve të ndërmjetësimit të referuara nga gjykatat?

4. Në mendimin tuaj, a i orientojnë në mënyrë të plotë gjyqtarët palët për mundësinë e shfrytëzimit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim?

5. Mendoni se duhet të parashikohet në legjislacion referimi i detyrueshëm në takimin fillestar me ndërmjetës përpara se të nisë procesi?

6. Cilat kategori çështjesh i konsideroni si më të përshtatshme për tu zgjidhur me ndërmjetësim?

7. Cilat mendoni se kanë qenë problematikat e deritanishme që kanë cuar në zbatimin e kufizuar të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve?